



Albanian Platform for Policy Advocacy

Ekipi

BULETIN
JANAR – SHKURT
2016

Adela DANAJ
Blerina LLALLA
Brenton KOTORRI
Elena PICI
Endrit KAPAJ
Ergisa BEJKOLLARI
Flutura GJANA
Gerion TRESKA
Marcela TRINGAJ
Megi LLUBANI
Mimi BARUSHI
Mirilda TILI
Rezarta CAUSHAJ
Rigels XHEMOLLARI
Sokol KONDI

*Faktet, analizat dhe qëndrimet e publikuara nga APPA,
nuk shprehin opinionin e partnerëve tanë.

KRYEMINISTRIA

Mirilda TILI, BA

Unë dua të jetoj në Shqipërinë që pasqyron kryeministri i vendit tim, Edi Rama, nga profili i tij në Facebook, apo edhe nga lajmet që prodhohen nga zyrat e shtypit. Zyra këto që edhe emri ju është hequr si i tillë, pasi shërbejnë si zyra këshillimi. Në atëçfarë mund të shohësh nga ajo që shpaloset, janë reklamat e bizneseve të mëdha, që kryeministri ka marrë përsipër të përcjellë. Aty shfaqen kompani serioze që investojnë në këtë vend, të cilët ushtrojnë aktiviteitn e tyre në një parajsë fiskale. Aty zonjat dhe zonjushat janë në pozicionet e tyre dinjitoze, të paofenduara dhe lënduara në asnjë milimetër të qenies së tyre, shpirtërore, intelektuale apo edhe fizike. Madje edhe kabineti qeveritar, në komunikimin zyrtar të Këshillit të Ministrave nuk ka ndryshuar, edhe pse u shkarkua në kushtet e urgjencës ministri i financave, Shkëlqim Cani, u bë një ndërrim vendi për atë të ekonomisë, Arben Ahmetaj, dhe një zëvendës minsitre u bë ministre. Të gjitha këto ndryshime nuk janë pasqyruar në listën e kabinetit qeveritar. Në debatet që ka prodhuar qeverisja e vendit nuk kanë munguar as marrëveshjet për muxhahedinët dhe as debatet për dekriminalizimin e parlamentit.

1. Çfarë shenjohet për këto 2 muaj?

Edhe pse kur e sollën në Shqipëri, "Crwon Agent", u trumbetua si shpëtimtarja e mbledhjes së të ardhurave nga doganat, trajnimit të personelit dhe kontrollit të produkteve, ajo u përzu. Qeveria shqiptare nënshkroi një kontratë në nëntor 2013 me kompaninë angleze Crown Agents, një korporatë ndërkombëtare me prani në

dhjetëra shtete. Në bazë të kontratës, Crown Agents do të përfitonte 4.1 milionë euro në vit (të përjashtuara nga taksat) dhe në këmbim, do të ndihmonte doganat shqiptare për të zbatuar më mirë ligjet aktuale. Crown Agents merrte përsipër të kryente inspektive, të zbulonte shkelje doganore, të identifikonte të ardhura të munguara, të fuste praktika moderne në analizimin e rrezikut dhe rrjedhimisht, identifikimin e evazionit, të luftonte korrupsionin në dogana, të përmirësonte cilësinë e administratës përmes trajnimeve etj. Në fund, të gjitha këto masa, duhej t'i jepnin Shqipërisë "një rritje prej 1% në vit në nivelin e të ardhurave doganore të mbledhura nga Administrata Doganore, shprehur si përqindje e PBB-së". Kjo është çfarë është shkruar në kontratë. Kjo ishte pjesë e kontratës e publikuar edhe në webin e tyre. Por nëse pati ndodnjë pikë të realizuar në atë kontratë do të ishte e sigurt që njëra nuk mund të ishte. Nuk u zbatua kushti i të mbledhurit të të ardhurave.

"Gjatë vitit 2014, doganat shqiptare siguruan 150.7 miliardë lekë të ardhura për buxhetin e shtetit. Vlerësimi i FMN-së për PBB-në e Shqipërisë qe afro 1.4 trilionë lekë, dhe të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për vitin 2014 qenë afërsisht 10.8 për qind e PBB-së. Kjo qe vetëm 0.4 për qind të PBB-së më shumë se sa në vitin 2013. Por duhet të kemi parasysh se në fund të vitit 2013, qeveria shqiptare rriti taksat mbi cigaret dhe karburantet, të cilat mbledhen në dogana, atëherë qeveria duhej të mbledhte rreth 100 milionë euro vetëm nga rritja e taksave dhe 100 milionë të tjera nga puna e Crown Agents, ose, gati 2 për qind të PBB-së më shumë. Për këtë arsye, rritja e të ardhurave me 0.4 për qind të PBB-së sugjeron njëkohësisht që puna e Crown Agents nuk qe efektive dhe rritja e taksave qe një dështim total." Dhe meqë dështimi ishte një fitore në xhep, atëherë kjo

kompani u përzu dhe u sheqeros si deklaratë kur kryeministri i vendit, Edi Rama, u shpreh se tani do të punohet në bazë të modelit që kanë lënë pas kjo agjenci këshillimore. A duhet ta kuptojmë këtë, që do vazhdojnë të rriten taksat dhe po në të njëjtën mënyrë do të zhytet edhe niveli i të ardhurave? Megjithatë, kjo nuk ishte lëvizja e vetme me kosto ekonomike dhe financiare. Nëse largimi i "Crown Agents" deri diku pritej të ndodhte, shkarkimi në mënyrë të rrufeshme e Ministrit të Financave, Shkëlqim Cani, në një kohë kur thuhej me zë të lartë se nuk do të kishte asnjë lëvizje në qeverisje, ishte një tjetër shkrepëtimë në qiell të hapur. Në atë qiell kur rilindja ekonomike po "rrit" cilësinë e jetës për 1 milion votuesit e saj. "Lajmi nuk është që u shkarkua Ministri i Financave Cani, lajmi është që u shkarkua me spektakël Ministri i njohur si njeriu i Fondit Monetar. Në fakt zoti Cani ishte partizani dhe ideologu kryesor i Taksës Progresive, i shtimit të disa taksave dhe tarifave, i ndryshimit të të gjithë skemës financiare të vendit e cila për hir të vërtetës dështoi këto 3 vite, i kontabilizimit të borxhit të brendshëm bashkë me borxhin e jashtëm etj. Natyrisht lind pyetja a ishte faji i zotit Cani ky dështim, natyrisht që jo, por nga ana tjetër vetë Kryeministri nuk mund të jepte dorëheqje ose të vetëshkarkohej. Po ashtu nuk mund të shkarkohet Guru i Finances neo-majtiste botërore Ricardo Hausman të cilit i është referuar qeveria në të gjitha çmenduritë e bëra me financat publike në 3 vitet e fundit, i cili jeton përtej Atlantikut dhe paguhet me paratë e SOROS. Po ashtu nuk mund të shkarkohej kompania tashmë e larguar Crown Agent e cila për të mos ndotur emrin e vet po i nxjerr ujën e zi dëshmime për kontrabandë dhe evazion të organizuar. Në fakt shkarkimi i zotit Cani është dëshmia më e qartë e dështimit më të madh të kësaj qeverie, dështimit të Financave publike, borxhi publik u rrit me gati 15 përqind më shumë, ekonomia ra dhe vështirë të ngrihet

në 1 vit edhe pak që ka ngelur dhe shqiptarët duhet të duartrokasin në vazhdim "sukseset dhe fitoret"- ky ishte qëndrimi që mbajti analisti Ilir Kulla, pas shkarkimit më fletë lavdërimi të ministrit të Financave, Shkëlqim Cani. Dikasteri i financave, iu besua ministrit të Ekonomisë, Arben Ahmetaj. Kjo lëvizje u duk edhe më e rrezikshme, pasi ministria e ekonomisë nuk vjen aspak e shoqëruar nga rekorde pozitive. Dhe nëse do të bënim një analizë të thellë edhe këtij institucioni, do të shihnim që nuk do të ketë vetëm mungesë transparence, por edhe gënjeshtër të thëna publikisht. Mjafton të përmendim koncensionin e aeroportit të Rinasit. Pra mesa duket në këtë një vit e pak qeverisje që i ka mbetur këtij koalicioni, kemi edhe shumë për të parë dhe mësuar. E kemi fjalën për mungesënetransparencës, pasi do të shtohen edhe më tepër faqet zyrtare ku të bëhen denoncimet për korrupsion, por jo institucionet që do t'i japin fundin këtij fenomeni.

2. Politika e jashtëme me të përbrendshme.

Kemi viztën e famshme të sekretarit të Shtetit Amerikan John Kerry. Krimi, korrupsioni, sundimi i ligjit, reforma në drejtësi integrimi në BE dhe lufta kundër terrorizmit ishin temat për të cilat u diskutua në takim mes Sekretarit Amerikan të Shtetit, John Kerry dhe kryeministrit Rama. Madje këto i konfirmuan nga axhenda e Departamentit të Shtetit Amerikan.

Po DASH, shprehu shqetësimin për dekriminalizimin e Parlamentit në vendin tonë. Nuk mbetën jashtë axhende edhe zhvillimet ekonomike, investimet në turizëm e kudo me rradhë. Pra, e gjithë axhenda e sekretarit të shtetit, John Kerry, ishte e përmbledhur në shqetësimete vendit tonë. Në

dukje asnjë shqetësim jashtë territorit të vendit tonë. Edhe Amerikës i dhemb koka nga paçavuret që ne ndërtojmë së brendshmi. Kjo është fasada, sepse edhe marrëveshja me Amerikën për pranimin e muxhahedinëve në vendin tonë është një tjetër thikë me dy presa. Rreth asaj vizite u fol gjatë, shumë gjatë, si para dhe pas. Por në asnjë moment nuk u diksutua se si ndikoi vizita e Kerry-t në marrëdhëniet tona me Rusinë dhe pikërisht ndikimin rus këtu tek ne.

3. Qershia mbi tortë.

Ajo çfarë nuk do ti falej Kryeminsitrit të vendit, Edi Rama, përveç dështimeve të njëpasnjëshme me qeverisjen e tij, që nga premtimi për 300 mijë vende të reja punë dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian, si edhe një listë e gjatë e aksioneve të ndërmmara që nuk u kthyen kurrë në reforma, është edhe komunikimi me gratë e parlamentit. Nëse gjuajtja me vezë konsiderohet "protestë demokratike" edhe ofendimi nga ana e kryeministrit drejt deputetes së Partisë Demokratike, u konsiderua mënyrë të shprehuri. Madje, do të shkonte aq larg sa edhe u shpreh: "Keqardhje për zonjën deputete që abuzohet nga partia e saj, me pretendimin se e quajta monstër kur në fakt i thashë motër! Këtë e dëgjuan të gjithë. E dëgjoi zonja e dëgjuan edhe burrat, që medemek u revoltuan nga humori im dhe qëlluan me vezë, a thua se vezët i pollën në sallë kur fola unë ☺ Dhe pikërisht pse ata qëlluan me vezë (e jo zonja që kishte bërë një top me pako sheqeri të lagur), replika "gjinekologjike" nuk ishte për zonjën, po për burrat vezëlëshues! Pasi bënë 24 orë të revoltuarit pa lidhje, kanë 24 orë që po bëjnë të fyerit pa lidhje. Të kesh në vend të opozitës qeverinë e vjetër, është fakt i trishtueshëm i jetës demokratike. Por të kesh përballë qeverinë e vjetër duke kaluar një

ezaurim nervor, është edhe më keq. Është e dhimbshme."

Referenca:

<http://www.mapo.al/2016/02/ja-cfare-u-bisedua-ne-takimin-sekret-kerry-rama>

<http://www.mapo.al/2015/03/crown-agents-konsulenca-qe-nuk-solli-te-ardhura-shtese>

<http://www.kryeministria.al/al/>

<https://www.facebook.com/edirama.al/?fref=ts>

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Rigels XHEMOLLARI, MSc

1. MAS shkel hapur ligjin për të drejtën e informimit

Bazuar në ligjin Nr.119/2014 për të drejtën e informimit autoritetet publike, ku përfshihet edhe MAS, duhet të publikojnë Programin e Transparencës dhe Regjistrin e Kërkesave. Jo vetëm që nuk e ka publikuar programin model të transparencës, por MAS në faqen e saj mashtron qytetarin klikues duke pasur të shkruar vetëm fjalët "Programi i Transparencës" dhe "Regjistri i Kërkesave" dhe në momentin që klikohet nuk hapet asnjëra prej tyre.

Bazuar në ligj, titullari i institucionit duhet të mbajë përgjegjësi për shkeljen e nenit 6, 7 dhe të dënohet me gjobë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Për një qeverisje të mirë, të hapur dhe të aksesueshme nga qytetarët duhet që MAS të plotësojë menjëherë këto detyrime ligjore dhe KDIMP të japë masën ndëshkimore me gjobë ndaj titullarit të institucionit znj. Lindita Nikolli. Në këtë mënyrë ky institucion do të bëhet model për zbatimin e të drejtës së informimit edhe tek institucionet e varësisë si Drejtoritë Arsimore dhe Universitetet.

2. Raporti i UNICEF dhe AKP.10 % e nxënësve analfabetë, MAS fajëson prindërit

Në muajin janar MAS publikoi studimin e organizuar nga AKP për klasat e 3-ta dhe të 5-ta, ku ra në sy një sërë problematikash si 10% e nxënësve analfabetë, 60% e nxënësve nën nivelin mesatar dhe paraqitja e shkollave private superiore ndaj atyre publike.

Këto probleme u anashkaluan në deklaratën zyrtare të MAS duke theksuar se - "Statistikat tregojnë që në arritjet e nxënësve ndikojnë arsimimi dhe punësimi i prindërve, niveli ekonomik i familjeve të nxënësve dhe koha fizike që i duhet nxënësit për të shkuar në shkollë dhe rregulli i ndjekjes së shkollës nga ana e tyre."

Para se të fajësonte prindërit, Ministrja Nikolla duhet të kërkonte fajë për rezultatet e dobëta dhe nivelin e ulët të nxënësve.

Ky rezultat, që është më i dobët se ai i vitit të shkuar duhet të shoqërohet me shkarkime dhe përgjegjësi, por si duket zyra e Ministres Nikolla është munduar ta kthejë dobësinë në forcë duke mbuluar defektet e sistemit arsimor parauniversitar me mungesën e përkushtimit prindëror.

3. Matura shtetërore, nga hyrëse në dalëse

Prej vitit 2006 e deri më sot, çdo vit maturantët që duan të ndjekin shkollën e lartë janë përballur me ndryshimethelbësore të sistemit të pranimit dhe maturës shtetërore. Në datën 11.02.2016 nëpërmjet një udhëzimi për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2016, MAS e shndërroi maturën nga një sistem për t'u bërë pjesë e arsimit të lartë në një mekanizëm dalës nga arsimi parauniversitar. Që dmth Universitetet me vendimet që kanë nxjerrë përcaktojnë vetë kriteret e pranimit, bazuar në ligjin e ri për arsimin e lartë.

Ky ndryshim i menjëhershëm penalizon nxënësit që kanë investuar për 3 vite për lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje dhe vazhdon të pasojë ndryshimet e njëpasnjëshme që i bëhen sistemit, me qëllim përsosjen sipas autoriteteve por ata që përballen çdo vit me të panjohurën janë

nxënësit që çdo vit nuk e dinë se në cilën degë do përfundojnë.

Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të zhvillojë sesione informuese në të gjitha shkollat e mesme të vendit për të informuar nxënësit me ndryshimin e sistemit dhe për t'i orientuar në tregun e ri unviersitar. Gjithashtu sipas të gjitha informacioneve mesatarja dysHEME, e vendosur kriter nga MAS që pengon nxënësit të jenë student të universiteteve publike dhe private do të jetë nota 6.

4. I sigurt në internet, vetëm në shkollë!

Për shkak të shifrave alarmuese të ngacmimeve seksuale dhe kanosjeve të fëmijëve nëpërmjet internetit, ditën ndërkombëtare të "Internetit të sigurt", Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në datën 9 shkurt 2016.

Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte rritja e efikasitetit të ndërveprimit institucional në funksion të sigurisë online për fëmijët, por deri tani është ndërtuar një faqe interneti e cila gjendet në linkun <http://www.isigurt.al/isigurt>, e papërditësuar dhe e padobishme për t'ju ardhur në ndihmë të miturve.

Gjatë takimit Ministrja Nikolla u shpreh: "Bashkëpunimi i MAS me të gjithë operatorët e ofrimit të shërbimit të internetit në shkolla ka ruajtur të pacënuar politikën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për të mundësuar internet të sigurt në shkollat shqiptare".

Problemi qëndron se sipas sondazhit të miturit nuk rrezikohen nga përdorimi i internetit në shkollë, por në shtëpi dhe në qendra interneti dhe zgjidhja nuk është ndërtimi dhe financimi i portaleve me apo pa informacion, por përfshirja e edukimit për mbrojtjen nga rreziqet online në kurrikulat shkollore, bashkëpunimi me bordet e prindërve dhe rritja e kapaciteteve të policisë shkencore ku ende ka vështirësi në hetimin e kanosjeve online sidomos nëpërmjet rrjeteve sociale.

Referenca:

<http://www.arsimi.gov.al/al/program/programi-i-transparences/programi-i-transparences>

<http://shqiptarja.com/pdf/neë/256032743-Testimi-i-Agjencise-Kombetare-te-provimeve-per-nxenesit-e-9-vjecares.pdf>

<http://www.mapo.al/2016/01/malaj-me-te-miret-nxenesit-e-beratit-me-te-dobetit-ata-te-fierit>

<http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/zevendesministrja-malaj-ben-publik-udhezimin-per-maturen-sheterore>

http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/msh/2016/Udhezim_nr_1_dt_11.02.2016_MSh.pdf

<http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/matura-shteterore-ashgje-nuk-ndryshon-per-zhvillimin-dhe-miradministrimin-e-saj&page=1>

<http://www.arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/internet-i-sigurt-marreveshje-mes-kater-ministrive&page=1>

MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJRAVE

Marcela Tringaj, LLM

1. Nga Fitorja, në Fitore!

Në takimin përmbyllës të fundvitit Ministri i Bujqësisë citoi i kënaqur shifrat dhe arritjet impulsive për vitin 2015. Edhe pse fermerët dhe tregtarët e nisën dhe mbyllën këtë vit me ujë deri në gju, bujqësia shqiptare ia arriti të përjetonte arritje mbreslënëse, cituar kjo nga vetë Ministri, gjatë prezantimit të analizës vjetore. Pas përshkrimit të tij optimist për situatën e vitit që lam pas, Ministri nuk kishte si mos të vinte në dukje zotimin e tij ndaj sfidave më thelbësore të digasterit që drejton. Siguria ushqimore, financimi dhe stimulimi i përdorimit të teknologjive të zhvilluara do të jenë prioriteti i politikave të Ministrisë së Bujqësisë, për të siguruar rritjen dhe pse jo si një mundësi për t'u hapur drejt tregjeve të reja evropiane, në të ardhmen.

Sfidat filluan të marrin udhë që në ditët e para të këtij fillim viti. Puna nisi me intensitet për tërheqjen e ujërave nga 5 mijë hektarë ngazonat e përmbytura nga reshjet e dendura të fundvitit. Sikundër jemi mësuar me angazhimet serioze të qeverisë dhe digastereve vartëse mbasi ndodh "gjëma", ky rast nuk mund të ishte përjashtim. Programi i "Rimëkëmbjes nga përmbytjet" me komponentët e infrastrukturës në vlerën e 6.2 milion Euro dhe ai i kompensimit me 6,4 milion Euro, shpreson të çnjollojë gjithë dështimin e Ministrisë së Bujqësisë për të shmangur përmbytjet e përvitshme në vend.

Sigurisht, kjo situatë ishte e pritshme përderisa asnjë reformë në sistemin e kullimit dhe vaditjes nuk është ndërmarrë asnjëherë

seriozisht. Duhet kohë, pretendohet, përderisa shumë përgjegjësi tashmë i kalojnë pushtetit vendor. Por sa kohë? A s'kanë mjaftuar dhjetëra përmbytje për t'i dhënë një mesazh vendimarrësve në Ministrinë e Bujqësisë sesi kushton më pak parandalimi i një dëmi sesa riparimi i tij? Ndonjë gjë të re nuk na tha as kolegu i koalicionit, Erion Braçe përmes kritikës së tij. Ne të gjithë dimë përgjigjen e dështimit moral të Ministrisë së Bujqësisë dhe drejtuesve rajonal të cilët nën opinionin e tij janë një grup njerëzish të paditur, të paafte, sa abuzues e më qëllimë banale partie. Ata janë duke shkatërruar ndërmarrjen më të mirë në vend.

Por kush paguan dhe e pëson në fund, kjo është çështja! Si ekspert i çdo fushe, Kryeministri Rama nga një vizitë tek fermerët e fshatit Kafaraj të Fierit, kultivues të luleshtrydheve e ka edhe një koment me titullin: "Pas përmbytjes së vjetshme, po dalim më të fortë së bashku". Kjo thënie, nuk di nëse duhet marrë si inkurajim për përmbytjet e ardhshme e si një thirrje për të qenë më largpamës apo si demagogji për të na bindur se jemi të pamposhtur nga çdo rrebesh e fati. Jo, në fakt, fermerëve nuk iu mbajnë më këllqet!

2. Ne jemi çfarë...na japin të hamë!

Përsa i përket sfidës së radhës, atë të sigurisë ushqimore dhe standardeve të produkteve të importuara, 'Fiks Fare' nxorri edhe një herë në dritë e vëmendje të publikut problemin e importit nga Greqia të pulave të shartimit. Këto pula, me vlera të kufizuara ushqimore, që prej vitit 2005 janë të ndaluara të importohen në vendin tonë. Agjentët doganorë të Janinës vazhdojnë të falsifikojnë lehtësisht certifikatat e origjinës së këtyre pulave, duke ndryshuar moshën nga 17-muajshe në pula 35-ditëshe, në

dokumente. Mashtrimi i drejtpërdrejtë i konsumatorit për moshën e pulave zbulon hallka të tjera pasigurie në konsumimin e këtyre pulave. Ushqimi, vaksinimi, ilacet që kanë bërë pulat me destinacion Shqipërinë janë disa nga elementët që ngrenë dyshimë të tjera lidhur me rrëzikshmërinë që paraqesin këto pula për konsumim.

Por nuk mbetet me kaq kjo histori. Kunati i ish-drejtorit të përgjithshëm të AKU është vulosësi i këtyre standardeve duke ndjekur një zinxhir bashkëpunimi me një firmë që nuk i lejohej të bënte import-eksport, drejtorit të Pikës së Inspektimit Kufitar Shqiptar në Gjirokastrë (institucion i varësuar nga AKU), si dhe kontrolli i AKU-së në doganë. Njëherë përgjithmonë, për t'i dhënë fund këtij abuzimi është nevojshme të ketë përpjekje serioze për të çrrënjësuar korrupsionin në nivele të larta por duke qenë se është kthyer në retorikë pandëshkueshmëria, sa do të vazhdojmë të mjaftohemi vetëm me pushime nga puna të atyre zyrtarëve të lartë që abuzojnë rëndë me detyrën.

Të jemi realistë, reforma e aksione ka por vetëm pjesën më vunerabël të shoqërisë. "Gjueti shtrigash" u kthye aksioni në Tiranë kundër shitësve të vegjël ambulantë që shpesh ofrojnë produkte nga fermat familjare. Dhe nëse flasim për produktet bujqësore për eksport, ato hasin barriera të larta mbrojtëse teksa kalojnë kufirin vendas e ku nga ana tjetër gjithfarë produkte të rrezikshme ushqimore hyjnë në Shqipëri pa kurrfarëproblemi dhe pa konsideruar minimalisht asnjë standarde evropian, bëjnë me turp dhe faj vetëm autoritetët përgjegjësë shqiptare. Kjo nuk është e ndershme aspak!

3. Reforma, reforma, reforma...

Një sfidë madhe për Ministrinë e Bujqësisë qëndron në mbështetjen e metejshme serioze

përmes reformave politikave për të krijuar një mjedis favorizues për zhvillimin e zonave rurale. Korrupsioni, shpesh shkelja flagrante e ligjeve të aprovuara, paaftësia për shfrytëzimin e potencialeve aktuale në bujqësi, mungesa e transparencës, infrastruktura që lë për të dëshiruar dhe një teknologji inovative në zonat rurale minon aftësinë zhvillimit të një industrie agropërpunuese për të zbutur në një farë mënyre disnivelet e prosperitetit krahasuar me industrinë tjera më shumë të zhvilluara në vend. Përpos të gjithave, informacioni dhe mundësia për të marrë mbështetje nga fonde të caktuara veshtirë se mbërrijnë në kohë tek fermerët që jetojnë në zona të thella. Krijimi i një mjedisi që nxit zhvillimin e industrisë agropërpunuese, por edhe të tjerave në zonat rurale dhe jo vetëm, duhet të jenë prioriteti investimeve në bujqësi për një rritje më të qëndrueshme ekonomike në vend.

Sigurisht duhet rritur niveli i akreditimit në bujqësi dhe ajo çka është lajm i mirë për bujqësinë, këtë fillim viti është fakti se BERZH vendos 75 milionë euro si fond garancie për kreditimin e bujqësisë nga bankat e nivelit të dytë. Programi për Mbështetjen e Agrobiznesit në Shqipëri cilësohet si një mekanizëm i ri financiar në mbështetje të bizneseve bujqësore prodhuese dhe agropërpunuese, me qëllim nxitjen e investimeve dhe kreditimit bankar bujqësor.

Por mbetet ende e paqartë se si do të ndahet risku mes qeverisë dhe bankave, në rastin e kredive që do të rezultojnë problematike. Përpos këtij problemi, Ministria e Bujqësisë duhet të aftësohet në shfrytëzimin e potencialave aktuale në sektorin e agrobiznesit. Kjo industri në radhë të parë duhet të diktojë dhe aftësinë fermerëve jo vetëm për prodhimin në cilësi të lartë për përmbushjen e kërkesës së brendshme por dhe për një rritje kapacitetesh për eksport. Mbetemi në pritje të impaktit dhe

zhvillimeve të financimeve së agrobizneseve nga fondi i fundit i BERZH. Si një thirrje për reflektim, Ambasadori Lu ka një apel të fortë për ministrin e bujqësisë jo vetëm për të: Shqipëria nuk është Tirana dhe se pjesa më e madhe e këtij vendi të bukur mbetet rurale dhe bujqësore. Ai shton sesa herë do të shikoj dele do të na kujtojë. Ne jemi ende në pritje të fjalëve të mençura të Ministrit Panariti, ashtu sikundër u shpreh Ambasadori Lu. Për vepra të mençura ka ende kohë!

<http://www.oranews.tv/vendi/eksportet-ne-bujqesi-ministri-panariti-paralajmeron-reforme-te-thelle/>

<http://shqiperiaime.al/2016/02/23/ironia-e-donald-lu-kur-te-shoh-nje-tufe-delesh-do-tju-mendoj/>

<https://www.facebook.com/media/set/?set=a.10153506526001523.1073742961.138734771522&type=3>

Referenca:

<http://www.bujqesia.gov.al>

<http://www.gazeta-shqip.com/lajme/?s=bujq%C3%ABsi>

<http://www.balkanweb.com/site/brace-sulm-ministrise-se-bujqesise-nje-grusht-te-paaftesh-panariti-reagon-arritjet-ne-lushnje-fale-meje/>

<http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/02/02/pulat-dyvjecare-kalojne-kufirin-si-pula-njemuajshe/>

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=389361>

<http://www.newsbomb.al/index.php/aktualitet/item/31676-kunati-i-drejtorit-te-aku-se-vulos-kalimin-e-pulave-te-skartuara-nga-greqia-ne-shqiperi>

<http://www.balkanweb.com/site/skanimi-i-ushqimeve-ne-dogana-zusi-rrezikon-shendetin-fleming-ska-asnje-ndikim/>

<http://www.gazeta-shqip.com/lajme/2016/01/12/berzh-krijon-fond-garancie-75-mln-euro-per-bujqesine/>

MINISTRIA E DREJTËSISË

Endrit KAPAJ, MSc & LL.M

Ministria e Drejtësisë, në këtë fillim viti, ka ndërmarrë disa iniciativa konkrete me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve të insitucioneve të varësisë.

1. Fund rradhave në dyert e Hipotekës.

Nëpërmjet një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Dhomës Kombëtare të Noterëve (DHKN) dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), synohet të realizohet një projekt pilot në Bashkinë e Tiranës ku tashmë aplikimi për shërbimet e ZRPP të kryhen nga Noteri, pra në këtë mënyrë u jepet e drejta noterëve për të aplikuar online në regjistrin elektronik të pasurive.¹

Nisur edhe nga përshtypja e publikut lidhur me korrupsionin dhe cilësinë e shërbimeve pranë ZRPP-ve, duhet thënë se kjo iniciativë jo vetëm që lehtëson barrierat burokratike por në të njëjten kohë kufizon kontaktin nëpunës/publik duke reduktuar mundësitë e mitmarrjes. Gjithashtu, nëpërmjet aplikimeve online synohet të rritet efikasiteti në veprimet administrative duke patur afate të paracaktuara dhe të verifikueshme.

2. Mbrojtje dhe siguri juridike në kontratat e shit/blerjes të pasurive të paluajtshme.

Duke mbetur përseri tek pasuritë e paluajtshme, Ministri i Drejtësisë ka mbrojtur

¹<http://www.drejtësia.gov.al/al/newsroom/lajme/nis-aplikimi-online-nga-zyra-e-noterit-per-27-sherbime-te-zrpp&page=2>

dhe dhënë shpjegime para Komisionit të Ligjeve në lidhje me projekt ligjin "Mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme".² Ky projekt ligj synon rritjen e sigurisë juridike në qarkullimin civil të sendeve të paluajtshme që I nënshtrohen rregjistrimit, duke I dhënë fund spekulimeve në kurriz të qytetarëve, të cilët kanë rënë pre e shitjeve fiktive dhe mashtrimeve. Gjithashtu, duke futur në kuadër formal dhe stabilizuar kredidhënien nga sektori bankar në Shqipëri.

3. Avokatët në grevë, kërkojnë ndryshimin e ligjit për përcaktimin apriori të masës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Gjatë muajit shkurt, Dhoma Kombëtare e Avokatëve (DHKA) shpalli dy greva të njëpasnjëshme, me datë 8 shkurt dhe një greve tjetër tre ditore, në datat 24 deri 26 shkurt. Dhoma Kombëtare e Avokatëve, nëpërmjet kësaj greve kërkon ndryshime ligjore për përcaktimin e pagës mujore, për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për avokatët e regjistruar si të vetpunësuar³.

Avokatët në rang vendi bojkotuan, duke mos marrë pjesë, të gjitha seancat në gjykatat e të gjitha niveleve, përveç rasteve të masave të sigurimit personal. Zhvillimi i kësaj greve paralizoi funksionimin normal të Gjykatave, duke detyruar Ministrin e Drejtësisë të ulet në tryezë me përfaqësuesit e Dhomës Kombëtare të Avokatëve për të gjetur rrugët e zgjidhjes. Lidhur me këtë problem,

²<http://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2016/01/Raporti-i-Komisionit-p-r-----shtjet-Ligjore-Administrat--n-Publike-dhe-t---Drejtat-e-Njeriut-1.pdf>

³<http://www.dhka.org.al/>

Presidenca e CCBE (Këshillit të Bareve dhe Shoqërive Ligjore të Europës) ka dërguar pranë Kryeministrit Edi Rama një letër ankese ku kërkon tërheqjen e Qeverisë nga kjo iniciativë lidhur me Avokatët⁴.

Rritja e pragut për përcaktimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ndikon negativisht kryesisht për Avokatët e rinj, për të cilët bëhet e papërballueshme financiarisht ushtrimi i aktivitetit të tyre duke çuar në mbylljen e aktivitetit dhe çregjistrimin e tyre nga organet fiskale. Gjithashtu, kjo rritje godet edhe Avokatët të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qytete dhe rrethe të tjera, duke patur parasysh aktivitetin dhe masën e shpërblimit të reduktuar.

4. Kthimi I pronave një (pa) drejtësi pafund.

Ministria e Drejtësisë aktualisht është duke u përballur me kundërshti të shumta në lidhje me miratimin e ligjit "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave", ose siç njihet si ligji për kompesimin e ish pronarëve⁵.

Kundërshtitë kanë qenë mjaft të forta në lidhje me vlerën monetare të kompesimit të sipërfaqeve të shtetëzuara gjatë periudhës 1945 deri 1990. Këto kundërshti nga grupet e interesit si shoqatat e ndryshme të ish pronarëve kanë mbërritur në dyert e Gjykatës Kushtetuese. Në eventualitetin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese në favor të pretendimeve të ish pronarëve duke shpallur si antikushtetues dispozitat e ligjit të mësipërm, përsëri do të bënte që Agjensia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave të ndryshonte kuadrin rregullator dhe funksional

⁴<http://dhka.org.al/index.php/hyrje/njoftime/99-ccbe-kryeministri-rama>

⁵http://www.drejtesia.gov.al/files/userfiles/Legjisllacioni/Draft_ligji_i_pronave-02-26qershor.pdf

të saj duke çuar në zvarritje të vendimmarrjes së saj për dosjet që presin aty me vite dhe ndoshta me dekada.

Disa fjalë mbi Reformën në Drejtësi.

Reforma e sistemit vjen si domosdoshmëri, si një kërkesë e opinionit publik, e shprehur fort dhe qartë në të gjitha sondazhet e perceptimit të këtij sektori si të korrumpuar, jo eficient dhe jo gjithmonë në shërbim të realizimit të drejtësisë.

Komisionit të posaçëm të ngritur për këtë qëllim i janë ngarkuar tri detyra:

1. të skanojë tërësisht sistemin e drejtësisë;
2. të përgatisë dokumentin e politikave ku do të përcaktohen objektivat e ndërhyrjes apo dhe synimet afatgjata;
3. hartimin e paketës së nderhyrjeve Kushtetuese.

Komisioni asistohet nga ekspertë të nivelit të lartë vendas dhe ndërkombëtar, ku produktet e punës së tyre mund ti gjeni on line <http://reformedrejttesi.al/>

Çështja e adresimit të besimit social të humbur, rendit ligjor dhe institucioneve. Lufta kundër korrupsionit ka peshën më të madhe: Institucionet ngrihen nga besimi i publikut i shprehur me votë, dhe nga besimi i publikut për të kontribuar nëpërmjet taksave për të bërë që institucionet të funksionojnë. Pra njerëzit i besojnë politikanëve dhe administratorëve paratë dhe votën dhe kanë të drejtë të kërkojnë të mos u shkelet kontrata e besimit. Çdo praktikë e abuzimit, qoftë edhe perceptimi, kanë efekt rrënues për besimin e qytetarëve tek institucionet e shtetit të cilin e ndërtojnë me votën dhe paratë e tyre.

Nëse sot ka reforma të rëndësishme që reduktojnë hapësirat për korrupsion, ende nuk mund të thuhet e njëjta gjë për ndëshkimin e rasteve. Retorika politike nuk lejon të shikohet me objektivitet as nga vëzhgues të pavarur se çfare ndodh me luftimin e rasteve të korrupsionit. Një nga konsideratat e përgjithshme që janë kthyer në klishe të të gjykuarit edhe në nivele studiuesish, apo analizash të pavarura është se krimi i korrupsionit nuk po ndëshkohet. Kjo bëhet edhe më e besueshme kur bëhet fjalë për raste të dështimit të drejtësisë të provojë fajësi për nivele të larta të politikës, të cilat natyrshëm tërheqin më shumë vëmendje. Por nëse shikojmë të dhënat e Prokurorisë, hetimi i denoncimeve për korrupsion dhe paraqitja në gjyq e tyre në mënyrë të suksesshme, pra fituese nga ana e prokurorisë ka një shkallë më të lartë se veprat e tjera penale. Nëse mesatarja e veprave të tjera penale është diku tek 30% hetim i suksesshëm dhe fitimi i çështjes në gjykatë, për veprën e korrupsionit kjo është gati 60%. Por vëmendja e analizës, studimeve dhe e publikut, por edhe më keq e atyre që janë të interesuar për fushën mbetet e gozhduar tek konsiderata e përgjithshme që korrupsioni nuk dënohet. Me sa duket perceptimi kërkohet të luftohet po me perceptim, vetëm po u dënua ndonjë zyrtar i lartë kemi suksese.

Kjo reformë, miratimi dhe zbatimi i nismave konkrete është kërkuar me zë të lartë, fort dhe qartë nga partnerët ndërkombëtarë në lehtësim të prespektivës europiane të vendit tonë.

APPA do të jetë në monitorim të vazhdueshëm, me raporte të veçanta, të punës së Komisionit dhe zbatimit të kësaj reforme duke vlerësuar, shqyrtuar çdo propozim nga të gjithë aktorët politike apo grupet e interesit.

MINISTRIA E ENERGJISE DHE INDUSTRISE

Ergisa BEJKOLLARI, BA

Ajo që mendohej si një nga sukseset më të mëdhaja të qeverisë në fakt na qenkërka një mashtrim!

Nëse ka një gjë që do justifikonte aksionin e ndezur të qeverisë "E ke paguar faturën tënde të energjisë? Nëse jo atëhere direkt e në burg!", ishte që të ardhurat të shkonin në vendin e duhur. Të paktën këtë shpresuam të gjithë. Ndoshta strategjia ishte pak e "dhunshme" por menduam se kjo gjë duhej bërë, ata që s'kishin paguar energjinë elektrike duheshin dënuar, edhe nëse për momentin s'kishin bukë të hanin. Tani çfarë ndodh? Sipas një investigimi të Reporter.al, Ministria e Energjisë dhe Industrisë na paska gënjyer të gjithëve. Prej një viti thuhej nëpër media se si rrjedhojë e fushtaës agresive për grumbullimin e pagesave, ajo kishte arkëtuar plot 59.4 miliardë lekë, që tregonin një rritje prej 16,5 miliardë lekësh nga viti I kaluar. Por mjaftoi një Pasqyrë e të Ardhurave dhe Shpenzimeve e OSSHE-së për periudhën operative 2015, që të kuptonim që në fakt të Ardhurat Gjithësej = 54.2 miliardë lekë. 5.2 miliardë lekë më pak se ajo që kishte deklaruar ministri! Edhe rritja e të ardhurave nuk është më 16.5 miliardë lekë por 7 miliardë lekë, dy herë më e vogël! Kjo gjë ngre 3 probleme shumë të mëdhaja: a) Hidhet poshtë strategjia e ndjekur e burgosjes së 2600 personave, sepse mesa shohim rezultatet edhe pas përdorimit të kësaj forme, nuk kanë qenë ato që duhej të ishin. b) Me çfarë të drejte ministria arrin të desinformojë publikun, vetëm e vetëm që të justifikojë taktikat e saj të cilat u konsideruan

dhe si shkelje e të drejtave? c) Do mjaftonte një audit I jashtëm ose një kontroll I thjeshtë për të kuptuar sesi janë manipuluar të dhënat. Pra ministria ose nuk ka pranuar të kontrollohet, ose ka arritur "të blejë" rezultatet që kanë dalë nga kontrolli. Përfundimisht hapet një gropë e madhe të pavërtetash dhe dyshimesh. Është urgjente çështja e kontraktimit të një auditi për të gjitha institucionet. Sepse nëse qenka kaq e thjeshtë, për sa gjëra të tjera ka gënjyer ministria?

2. "Fati i zi" i arit të zi

Paralizimi i ekonomisë botërore si pasojë e uljes së çmimit të naftës, prek veçanërisht vendin tonë për dy arsye:

- Nafta është produkti që eksportojmë më shumë.
- Nëse çmimi mesatar i naftës së huaj është 30-32 dollarë për fuçi, nafta e eksportuar nga vendi ynë shitet me 20 dollarë.

Ulja e çmimeve rrjedhimisht bën që kompanitë të mos përballojnë dot kostot dhe si pasojë të shkojnë direkt tek zgjidhja më e thjeshtë: pushimi nga puna i punonjësve. Që nga shtatori i vitit 2015, 500 naftëtarë janë dërguar në shtëpi. Ndryshimin e ka ndjerë dhe Bankers Petroleum, i cili ende nuk ka bërë shkurtime, ama një nga ndërmjetësit e tij, "Phoenix", ka nisur të hartojë planin e shkurtimeve. Ndërkohë kompania e madhe e nxjerrjes dhe kërkimit të naftës në vend, Transoil Group, planifikon të pushojë 66% të 150 punonjësve të saj. Duke qenë se shkurtimi i punonjësve në rast krize është strategjia e fundit që ndjek një kompani, kjo gjë reflekton sa e rëndësishme situata. Për më tepër që zonat ku këto kompani veprojnë janë zona në të cilat banorët "mbahen" me industrinë e naftës. Vetëm në Patos Marinëz ka 4000 naftëtarë!

Çështja rëndohet akoma më shumë kur Bankers Petroleum vendos të pezullojë aktivitetin për 6 muajt e ardhshëm, deri në stabilizimin e çmimeve. Edhe Transatlantic Petroleum ka shkurtuar në nivel minimal shpenzimet, pavarësisht se nuk ka zgjedhur të ulë numrin e punonjësve. Më tej, zëdhënës nga të dyja kompanitë kanë thënë se nëse rënia e çmimeve do të vazhdojë dhe për 6-muajt e ardhshëm, atëherë do të mbyllet i gjithë aktiviteti.

E gjithë kjo situatë ngërçi e vendos shtetin shqiptar përballë 3 problemeve:

- a) Duke qenë se financat nuk e parashikuan dot uljen e çmimit dhe pasojat, qeveria do ta ketë shumë të vështirë përballimin e pasojave në ekonomi. Sa më të papërgatitur të jemi përballë një situatë, aq më të larta janë humbjet.
- b) Në kësi rastesh, kur kompanitë shihen si shumë rrisht, është shumë i vështirë, gati i pamundur financimii tyre për shlyerjen e shpenzimeve, pagave etj.
- c) Fuqia jonë kryesore është pikërisht nafta, e cila kontribuon në Prodhimin e Brendshëm Bruto me 3%. Kontributi do ishte akoma më i lartë nëse për vitin 2014 ato do të kishin deklaruar Tatim Fitimin. Kështu që paralizimi I tregtisë së saj ka efekte veçanërisht të rënda për ekonominë shqiptare.

3. "Jelekë shpëtimi" dhe për industrinë minerare...

Sektori i kromit dhe i minierave të llogaritura sëbashku përbëjnë 0.7% të të ardhurave. Numri i të punësuarve në vitin 2013 ka qenë 3800 (0.3% e forcës punëtore të regjistruar) dhe në vitin 2014, 4300 të punësuar, shifër e cila përbën 0.4% të fuqisë punëtore gjithsej të regjistruar. Shifra që gjithsesi konsiderohen të papërfillshme. Aq edhe më

tëpaëprfillshme do bëhen me krizën e naftës dhe problemet me të cilat po përballlet sektori minerar.

- a) Shumë burokracira! Edhe nëse një subjekti I jepet leja për zhvillimin e aktivitetit minerar, do ketë patjetër përplasje me pushtetin lokal. Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit midis këtij të fundit dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, vonon nisjen e aktivitetit deri në një vit. Si rrjedhojë, shpeshherë, subjektit i është hequr leja.
- b) Një tjetër pengesë për t'u kaluar është dhe dalja nga Fondi Pyjor, procedurë që po ashtu kërkon kohë, ndonëjherë edhe vitë të tëra. Pra pasi ka kaluar gati gjysma e mandatit, ministritë kujtohen pikërisht tani se ka një mungesë komunikimi dhe bashkëpunimi midis tyre, duke lënë përgjysëm kushedi sa e sa sipërmarrje.
- c) Qëndrojmë sërish tek lënda drusore por këtë herë si një element i nevojshëm në procesin e nxjerrjes së minerareve. Lënda drusore e nevojshme në këtë sektor duhet të jetë e njomë, pra e sapoprerë, kësisoj përjashtohet mundësia që ajo të importohet. E vetmja zgjidhje është të shfytëzohen burimet vendase, të cilat edhe pa u përdorur për këtë qëllim, sërish janë të pamjaftueshme. Por, nëse zgjidhet kjo alternativë do duhet nënkotaktimi i disa kompanive për monitorimin e procesit të prerjes dhe transportimit të drurëve atje ku duhet. Çështja është: Sa besim kemi ne që këto kompani nuk do i tejshfrytezojnë burimet drusore edhe për interesa të tyre personale?

3 çështjet e mësipërme duket se do zgjidhen me komunikim midis institucioneve të përfshira, gjë e cila duhej parashikuar dhe zgjidhur që në fillim. Sipas revistës Monitor, dhjetëra miniera kromi u mbyllën në janarnë zonën e Martaneshit, për shkak se nuk përballonin dot uljen e çmimeve dhe rentën e

përcaktuar. U desh të ndodhte mbyllja e tyre, që rrjedhimisht solli dhe nxjerrjen nga puna të të punësuarve, që qeveria të niste përpjekjet për zvogëlimin e rentës.

<http://www.monitor.al/ekonomine-tone-rrezikon-ta-lere-karburanti-2/>

Propozohet që llogaritja e saj të bëhet në përqindje dhe jo fikse, duke qenë se çmimet ndryshojnë vazhdimisht. Pra me uljen e çmimeve do ulet dhe detyrimi që paguesit I kanë shtetit. Njëkohësisht, po mendohet që të ketë dhe një ulje të përqindjes me 2%.

Megjithatë, përpos dy situatave të zymta kemi dhe dy lajme relativisht të mira.

1. Bankers Petroleum pezulloi arbitrazhin ndaj qeverisë, si rrjedhojë e negociatave dypalëshe. U vendos që pas një auditimi nga prestigjozja PriceWater House, të dilet në një përfundim pas 4-muajsh.
2. U sqarua dhe përcaktua skema e shfrytëzimit të potencialit të Drinit të Zi. Më e mundshme është ajo e ndërtimit të dy HEC-eve: Katund i Ri dhe Skavica. Ku kjo e fundit u mendua të administrohej nga vetë KESH-i.

Referenca:

<http://www.monitor.al/minierat-ne-pritje-te-paketes-se-shpetimit-2/>

<http://www.monitor.al/zbardhet-nentoka/>

<http://www.energja.gov.al/al/njoftime/lajme/studimi-sugjeron-skemen-me-dy-diga-gjiknuri-skavicen-ta-ndertoje-kesh-katundin-e-ri-privati>

<http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=320279&ref=ml>

<http://www.energja.gov.al/al/njoftime/deklara-rata-per-shtyp/bankers-petroleum-pezullon-arbitrazhin-ndaj-shtetit-shqiptar&page=1>

MINISTRIA E FINANCAVE

Elena Pici, MSc

1. 'Rilindja' e 2016 – çfarë parashikohet në financa

Deficit në të ardhura dhe në shpenzime kapitale, shoqëruar me një borxh publik që 'fluturoi' mbi 70%-shin e prodhimit të brendshëm bruto – me këtë skenar e mbyllën financat vitin e kaluar⁶. Po t'i referohemi shifrave në raportet e përmuajshme publikuar në APPA, me keqardhje na duhet të pranojmë se përveç dhënies së kësteve të pagesave bizneseve private ndaj të cilave qeveria ndër vite kishte qënë debitore, financat nuk 'rilindën'. Këtë e kanë konstatuar dhe institucionet ndërkombëtare, të cilat kanë ulur vazhdimisht parashikimet e tyre për rritjen ekonomike të Shqipërisë për 2016-ën. Nga Prill 2015 ku parashikimet ishin rreth 4% rritje ekonomike, në Shkurt 2016 Komisioni Evropian parashikoi vetëm 3.2 % rritje ekonomike.

Megjithatë le t'u japim përparësi projekteve të së ardhmes, me shpresën që të jetë mësuar nga e shkuara. Përveç reformës së thellë në administrimin fiskal – bashkimi i doganave me tatimeve nën një menaxhim të vetëmi i cili u përfol gjatë fundvitit të kaluar, vëmendjen e gjithë financave e ka tërhequr së fundmi diskutimi për dhënie me koncesion të mbledhjes së TVSH-së, ose sic Kryeministri Rama e quan: parteneritet publik privat (PPP) –një shërbim qeveritar apo sipërmarrje private e cila themelohet dhe operon në bazë të një marreveshjeje afatgjate bashkëpunimit mes një organi të

⁶ Shtojmë, se Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN) miratoi në Shkurt dhënie e kështu të rradhës prej 72 milionë euro për vendin tone, duke e kështu në 155 milionë euro borxhin e dhënë nga FMN gjatë dy viteve të fundit, i cili, përderisa ka deficite kapitale, ku shkon?

qeverisë (qëndrore apo lokale\vendore) i cili ofron infrastrukturen e tij dhe një apo më shumë kompanive private që duhet të ofrojnë shërbim më cilësor dhe eficient. Propozimi i ka ardhur qeverisë Shqiptare nga një kompani nga Hong Kong-u⁷, relativisht modeste dhe e panjohur ndërkombëtarisht. Kompania nuk ka asnjë aktivitet të mëparshëm në Europë e aq më pak në Shqipëri; dhe nuk ka asnjë përvojë të mëparshme në fushën fiskale dhe nuk ka ndërtuar ndonjëherë ndonjë platformë apo zgjidhje si ajo që i propozoi qeverisë shqiptare. Sic raporton Exit.al fillimisht, Ministria e Financave e hodhi poshtë propozimin e kompanisë kineze, por në mesin e vitit 2015, me ndërhyrjen direkte të Ministrit të Ekonomisë Arben Ahmetaj (i cili bashkë me Kryeministrin Rama disa muaj më parë ishte në Hong Kong), Ministria e Financave vendosi, papritmas, ta rikonsiderojë propozimin kinez. Për këtë arsye, në Ministrinë e Financave u ngrit një grup pune për kryerjen e studimit të fizibilitetit të platformës elektronike të transmetimit të faturave elektronike. Megjithatë ky dokument nuk u mbështet nga drejtoresha e politikave fiskale Arjana Dyrmishi, e cila u detyrua të japë dorëheqjen. Ndërsa Ministri Cani, fillimisht, pranoi të jepte dakordësinë për koncesionin duke imponuar një kusht të rëndësishëm për pagesën e koncesionarit: pagesa të përfitohej vetëm nëse rritja e të ardhurave nga TVSH-ja të kalonte nivelin mesatar shumëvjeçar prej 11 përqind. Ky ishte një kusht shumë i rëndësishëm pasi logjika pas një PPP është rritja e eficiencës, në mungesë të cilës ky koncesion do të bëhet një barrë për tatimpaguesit dhe për buxhetin njëkohësisht.

⁷ Disa media kanë spekuluar se ka një bashkëpunim mes kësaj kompanie dhe një kompanie shqiptare të në cilën thuhet se vëllai i Kryeministrit z. Olsi Rama ka aksione. Kjo mbetet ende për t'u vërtetuar dhe përderisa nuk ka ende një tender të hapur nuk mund të flasim për konflikt interesi.

Ajo që të krijon dyshime nëse ky është një vendim politik apo financiar i arsyetuar, është se vetem disa ditë më parë Kryeministri Rama shkarkoi Ministrin Cani, duke u bërë kështu ministri i parë i kësaj qeverie që shkarkohet nga detyra, duke qënë se të mëparshmit që janë larguar nga detyra kanë dhënë dorëheqjen për arsye personale. Mesa duket qeverisë i duhen 'impluse të reja'⁸, por këto nuk janë aq të reja sa duken pasi në këtë pozicion u emërua (tashmë) ish-Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHETTS) z. Arben Ahmetaj, i cili siç shpjeguar më sipër është një mbështetës i kësaj nisme.

Reporter.al të cilët kontaktuan zyrën e Kryeministrit, bëjnë me dije se kjo e fundit u shpreh: 'Në momentin që flasim nuk ka asnjë garë apo tender të çelur për partneritetin publik privat në fjalë'. Megjithatë trendi është i qartë... Në përfundim, e shohim me skepticizëm një iniciativë të tillë e cila nukka ndonjë rast aplikimi apo suksesi në vende tjera të Bashkimit Europian apo të rajonit (bazuar në kërkimet online). Në fakt, një analizë e bërë nga kompania ndërkombëtare Deloitte për European Investment Bank në 2013⁹ arrin në konkluzionin se kjo nuk është e implementueshme dhe se PPP-të moderne duhet të synojnë deri në limitin e ndërtimit apo mirëmbajtjes së rrugëve, shkollave apo spitaleve. Edhe në rast të një iniciative të tillë, do të mbronim idenë e zhvillimit të kapaciteteve për një kompani Shqiptare e cila mund të ofrojë një shërbim të tillë, në mënyrë që dhe fitimi i konsiderueshëm që do të shkojë në favor të saj të investohet apo të shpenzohet i gjithi në tregun e brendshëm.

⁸Shkëputur nga deklaratat e z. Ilir Meta dhe z. Nasip Naco, kur gjatë fundvitit të kaluar ky i fundit dha dorëheqjen nga posti i Ministrisë të Drejtësisë

⁹Në këtë periudhë pati një diskutim nëse liberalizmi i tregut në Bashkimin Evropian duhet të shoqërohet me një PPP për mbedhjen e TVSH-së në të gjithë EU zone.

2. Largohen Crown Agent

Muaji Shkurt ka shënuar dhe përfundimin e kontratës 2-vjecare të Crown Agent në Shqipëri, e cila (fatmirësisht) nuk është rinovuar. APPA ka qënë vazhdimisht skeptike në raportet e saj të përmujshme në lidhje me eficientësinë e kësaj kompanie, e cila u shpërblye me 6.8 milionë euro për të bërë praktikisht... asgjë (ose të paktën asgjë e cila nuk u bë publike si benefit i kontributit të tyre). Kompania angleze, sipas kontratës, duhet të rriste të ardhurat doganore me 1 për qind të PBB-së në vit, ose rreth 100 milionë euro. Por, për vitin 2014 të ardhurat nga doganat u rritën vetëm 0,4 për qind të PBB-së nga një vit më parë. Crown Agent e mbylli qëndrimin e saj në Shqipëri me lajmin se në portet Shqiptare bëhet kontrabandë naftë dhe për këtë rekomandoi kontrollin e pikave të karburanteve, të autoboteve të transportit të naftës dhe dokumentet e çdo firme hidrokarburesh, për të kontrolluar nëse ka sasi naftë të paregjistruara. Ndërkohë, Ministri Cani (kur ende ishte në detyrë) e quajti diplomatikisht bashkëpunimin të suksesshëm dhe u shpreh se çelësi për mosrealizimet gjendet tek procedurat, antikontabandë, antikorrupsioni dhe tek analiza e riskut. Ngelet për t'u parë se cila do të jetë strategjia e Ministrisë të Ahmetaj në lidhje me institucionin e financave që lë më shumë për të dëshiruar. Në gjykimin tonë, asistencë dhe konsulencë e specilizuar do të ishte e nevojshme, për aq kohësa perzgjedhja e institucionit partner dhe termat e bashkëpunimit nuk bien pre e interesave klienteliste.

Referenca:

Exit.al. Shkurt 2016. *FMN i jep kestin Shqipërisë*.
<http://exit.al/2016/02/18/fmn-jep-72-milione-euro/>

Exit.al. Shkurt 2016.Nderkombetaret ulin
parashikimet e rritjes ekonomike.
<http://exit.al/2016/02/05/6674/>

Exit.al. Shkurt 2016.*Largohen Crown Agents.*
<http://exit.al/2016/02/12/6973/>

Reporter.al. Shkurt 2016.*Rama sharkon
Canin si Minister te Financave*
[http://www.reporter.al/rama-shkarkon-
shkelqim-canin-si-minister-financash](http://www.reporter.al/rama-shkarkon-shkelqim-canin-si-minister-financash)

MINISTRIA INTEGRIMIT

Rezarta Caushaj, BSc

1. Azilkërkimi?! Ende një keqkuptim i madh.

Ministri i Integrimit, Znj. Klajda Gjoshka ka zhvilluar takim me Ministren e Shtetit për Çështjet Europiane të Landit të Bavarisë, së Republikës Federale Gjermane znj. Beate Merk¹⁰, ku ndër të tjera ajo ka shprehur falenderimin për kontributin e Gjermanisë në ndihmën e dhënë gjatë vitit të shkuar për fenomenin të azilkërkimit. Më saktësisht, Ministri ka habitur kur ka falenderuar ambasadën Gjermane në Tiranë dhe vetë Znj. Merk për kontributin e saj personal gjatë vizitës në Tiranë në tetor 2015 për sensibilizimin e qytetarëve shqiptar për fenomenin, i cili sipas saj ka dhënë edhe efektin e dëshirueshëm të uljes së kërkesave nga ana e qytetarëve shqiptarë. Nëse i referohesh znj. Gjoshka, fenomeni i azilkërkimit gjeti një zgjidhje si pasojë e deklaratave të palës gjermane dhe jo prej shpalljes së Shqipërisë si një vend i sigurtë origjine si dhe riatdhësimi i një pjese të madhe të azilkërkuesve¹¹, e cila është ç'ka realisht ndodhi.

Tangencialisht, Znj. Gjoshka ndoshta dëshiron të marrë edhe merita për thirrjet e saj të herëpashërëshme se kërkimi i azilit vetëm dëmton shpresat tona për hapjen e negociatave, që në vetvete dëshmon për mungesën e masave parandaluese nga ana e palës shqiptare, duke filluar nga dështimi i Ministrisë së Brendshme për e rrjedhjes së popullsisë jashtë kufinjëve. Ndonëse nuk mund të heqim vërejtje për dhëniën e

¹⁰<http://www.integrimit.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-e-integrimit-europian-znj-klajda-gjoshka-vizite-zyrtare-ne-landin-e-bavarise-ne-gjermani&page=1>

¹¹<http://www.reporter.al/azilkerkuesit-shqiptare-ne-gjermani-ne-rritje-te-pandalshme/>

meritës partnerit tonë, Gjermanisë, në vetvete kjo deklaratë reflekton politikën e zgjedhur nga ana e Ministrisë së Integrimit përsa i përket problemit në fjalë, duke e trajtuar atë si një problem të mungesës së informimit nga ana e qytetarëve shqiptar, duke injoruar shkaqet kryesore të raportuara nëpër media gjërisht¹².

Natyrisht, nuk presim që Ministria e Integrimit të jetë drejtëpërdrejtë përgjegjëse për krizën e azilkërkuesve sepse këto problematika lidhen me një sërë politikash të nivelit kombëtar si papunësia, niveli i ulët i të ardhurave, inflacioni etj., ama, deklaratatë tilla hedhin dritë seriozitetin ose në rastin konkret mungesën e tij, më të cilin një institucion i angazhuar për të kontrolluar e dhënë shtysë integrimit, zhvlerëson eksodin në masë të një pjese të konsiderueshme të popullsisë. Ajo ç'ka do të na ndihmonte vërtetë në sytë e Gjermanisë, do ishte paraqitja e një qëndrimi, ku qeveria, e përfaqësuar nga Ministri, mbasi të ketë analizuar shkaqet e pafuqisë së vetë, ka vendos të përqëndrohet në ndërrmarrjen e politikave që luftojnë kërkimin e azilit.

2. Ngritja e kapaciteteve institucionale

Ndërkohë që në fillim të shkurtit Znj. Gjoshka ka qënë pjesëmarrëse në Berat¹³ për ndarjen e Certifikatave të Trajnimit të punonjësve të Bashkisë nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ajo ka deklaruar se të tilla trajnime zhvillohen në kuadër të zgjerimit të Njësive të Integrimit në nivel lokal, po edhe sepse me ndarjen e re administrative, Bashkive u jepet mundësia për

¹²<http://www.reporter.al/shqiptaret-e-deshperuar-sfidojne-shanset-e-vogla-per-azil-ne-gjermani/>

¹³<http://www.integrimit.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-gjoshka-domosdoshmeri-punonjesit-e-kualifikuar-me-shume-fonde-nga-be-ne-nivel-lokal&page=1>

të përthithur më shumë fonde nga programet e Bashkimit Europian. E marrë në parim trajnimi i punonjësve është një zhvillim pozitiv, por e vërteta është që mundësitë e Bashkive për të përfituar janë ende të cunguara. Një tregues i thjeshtë është mungesa e një raporti të Ministrisë mbi projektet e fituara nga Bashkitë, të financuara nga fondet IPA. Sidomos kur përfitimi i projekteve të tilla bëhet më urgjent për strukturat vendore, duke qënë se nga të dhënat e paraqitura në Open Data Albania, transfertat e pakushtëzuara do i marrin buxhetit të shtetit këtë vit rreth 11.8 mld lek, ku bëhet fjalë për plotësimin e diferencës së të ardhurave dhe shpenzimeve në nivelin lokal¹⁴. Nga ana tjetër, pikëpyetja mbetet, nëse trajnimi i punonjësve është i mjaftueshëm, ndërkohë që axhendat e institucioneve të ndryshme qeveritare janë të dominuara nga direktivat partiake.

Duket në këtë aspekt jo e paqëllimshme vizita e mësipërme, duke qënë se Znj. Gjoshka ka marr pjesë në 22 shkurt në Konferencën Përmbyllëse të Fazës së Tretë të Projektit të Asistencës Teknike të Bashkimit Evropian "Mbeshtetje pr Procesin e Integritimit - SMEI 3"¹⁵, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të vendeve fqinje. Në faqjen e ëebit të Ministrisë thuhet: "Ministrja, vlerësoi rolin e Projektit të Asistencës Teknike SMEI-3 në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimit dhe përmirimit të menaxhimit institucional dhe bashkpunimit ndër-institucional."

Përveç vlerësimit deklarativ, fatkeqësisht, nuk ka asnjë analizë në faqjen e Ministrisë mbi impaktin real të asistencës dhe a ka arritur të përmbush qellimet për perjudhën e

përcaktuar. As në faqjen e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike¹⁶, me të cilën Ministria e Integritimit thekson se është hartuar e zbatuar një plan për trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve, <http://www.aspa.gov.al/al/trajnime/kalendari> nuk arritëm të gjenim një informacion të tillë, madje vetë faqja është absolutisht fiktive dhe jo funksionale me perjashtim të një kalendari të paqartë e të pa menaxhuar, që mund të shihet. Pra, nuk mund të vërtetojmë nëse një plan i tillë ekziston dhe rrjedhimisht, as mundemi të gjykojmë mbarëvatjen apo cilësinë e tij.

Si për t'iu kundërpërgjigjur qasjes së vendit tonë mbi rritjen e kapaciteteve apo zbatimin të reformave në përgjithësi, e cila mbështetet vetëm me shprehjen e vullnetit të mirë, ka qënë Përfaqësuesi i Delegacionit të BE që ka vënë në dukje se këto reforma i përkasin sferës politike.

Më specifikisht, kërkohet që të kalohet në stadin e mirëqeverisjes ose synimit, jo thjeshtë të imlementimit të reformave, por zbatimin të politikave cilësore, impakti i të cilave të jetë i matshëm.

Ndërkohë që u theksua rëndësia e marrjes së statusit kandidat, ishte fqinji jonë Mali i Zi i cili ofroi eksperiencën e vet të suksesshme në këtë fushë, duke na rikujtuar se sa para nesh është në procesin e integritimit (përkundër pretendimeve tona).

3. (Mos)Koordinimi institucional dhe kriza e refugjateve

Ndoshta ngjarja më e debatuar e muajit të fundit, vjen pikërisht mbasi titullari i Ministrisë së Integritimit ka bërë një takim me Komitetin e Koordinimit Ndër-institucional për

¹⁴<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/1647/Transferta-e-pakushtezuar-dhe-transferta-specifike-sipas-bashkive-2016>

¹⁵<http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/lajme/zhvillohet-konferenca-permbyllese-e-projektit-te-asistences-teknike-te-bashkimit-europian-mbeshtetje-per-procesin-e-integritimit-smei-3>

¹⁶<http://www.aspa.gov.al/al/trajnime/kalendar>

Integrimin European¹⁷, për të diskutuar problematikat e hasura gjatë vitit të kaluar, të lidhura ngushtë me mospërmbushjen e detyrimeve nga Ministritë e linjës dhe koordinimin e dobët (e raportuar në Raporte të mëparshme të APPA-s). Lajmi i mirë është që sipas Znj. Gjoshë, raportimi tashmë do jetë i përmuajshëm dhe jo më me bazë 3 mujore. Shpresojmë që kjo të ndihmojë cilësisht në procesin e raportimit, por edhe përmbushjes së detyrimeve nga ministritë e linjës.

Megjithatë, moskoordinimi më i madh këtë muaj ka qënë midis Ministrisë së Integritit, asaj të Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme dhe Kryeministritë përse i përket çështjes së pranimit të refugjatëve në Shqipëri. Ndërkohë që deklaratat variojnë nga Ministria e Brendshme¹⁸ që thotë se Shqipëria ka marrë masa që nga shtatori i vitit të kaluar për përbalimin e fluksit të tyre, te Ministria e Integritit¹⁹ që deklaronte se pritet që një numër i konsiderueshëm refugjatësh të hyjnë në vendin tonë, te qëndrimi i pavendosur i Ministrisë së Mbrojtjes, e cila nga takimi në Komisionin për Sigurinë Kombëtare²⁰ ka lënë të kuptohet se Shqipëria do ndihmojë në menxhimin e krizës duke përcjellë refugjatët në vendet pritëse dhe së fundmi, te institucioni i Kryeministritë. Qartësisht, kemi të bëjmë me një shembull të pastër të moskoordinimit institucional sepse Kryeministri Z. Rama, ka rënë në kundërshti jo vetëm me Ministrinë e Integritit, por edhe me ato çka deklaronte rreth një viti më parë gjatë vizitës në Itali. Kryeministri ka qënë i prerë kur, i ftuar në emisionin Top Story, ka shpallur se Shqipëria nuk do t'i hap kufijtë. Më tepër se shfaqja e fenomenit të një

mungese komunikimi zyrtar midis institucioneve përgjegjëse, kemi të bëjmë me mungesën e një analize mbi mundësitë e hapjes së kufijëve, që mund të jetë përfituese duke pas parasysh ndihmën ndërkombëtare që akordohet më këto raste apo të një plani të mirëmenduar për menxhimin e krizës së refugjatëve, e cila mund të shfaqet në dimensione të ndryshme²¹, edhe me mbylljen e kufirit.

¹⁷<http://www.integrimi.gov.al/al/newsroom/lajme/ministria-gjoshë-mbledh-komitetin-e-koordinimit-nderinstitucional-per-integrimin-europian1455093638&page=1>

¹⁸<http://www.kohajone.com/2016/02/29/gjebrea-refugjatet-siriane-jemi-gati-te-perballemi/>

¹⁹

²⁰<http://www.balkanweb.com/site/kodheli-qeveria-i-ka-marre-te-gjitha-masat-per-refugjatet-nga-siria/>

²¹<http://www.reporter.al/shqiperia-nuk-e-ka-luksin-te-marre-vendim-per-refugjatet/>

MINISTRIA E KULTURES

Blerina LLALLA, MSc

1. Një Kadare dhe një Çul

Viti i ri i punës së Ministrisë së Kulturës, në muajin Janar u çel dhe u mbyll nën imazhin e shkrimtarit Ismail Kadare. Programi filloi me nënshkrimin e marrëveshjes për rijetëzimin e "Shtëpisë së Kadaresë" tashmë e restauruar plotësisht dhe nën administrimin e MK si monument kulturës i kategorisë së parë pas aktit të dhurimit nga vetë Kadareja. Kjo ngjarje zuri një pjesë të madhe në promovimin publik si një moment kulminant në veprimtarinë e MK-së, dhe si një ngjarje historike me karakter të veçantë. Kjo nismë lidhur dhe me vetë personalitetin e Kadaresë mbetet për tu vlerësuar, por nuk duhet të qëndrojë deri këtu, pasi ka edhe shumë artistë të tjerë në të gjitha fushat respektive të artit të cilët duhen vlerësuar sa janë në këtë jetë, po aq sa edhe të mbështeten në promovimin e artit të tyre duke u trajtuar nga këto insitucione. Përgjithësisht në kulturën tonë vihet re një tendence e orinetimit të gjitha investimeve në të gjitha kontekstet tek një, dy apo tre figura qendrore në jetën artistike publike kombëtare apo nderkombëtare duke riskuar kështu rezervimin e hapësirave për artistët e tjere, kjo nuk është problematikë vetem në lidhje me personalitetet e artit, por edhe në fushat e tjera ku të gjitha energjitë, kapacitetet promovuese institucionale fokusohen drejt një grupimi të caktuar individësh.

Inagurimi i Shtëpisë Muze të Kadaresë u bë në fund të muajit janar. Muaj i cili kish rezervuar edhe një ngjarje të

pakëndshme ku protagonist ishte një nga drejtuesit e institucioneve të kulturës duke provokuar reagime dhe debate të shumta në publik.

2. Një ngjarje e shëmtuar

Në ngjë nja ngjarjet më te bujshme të muajit janar bën pjesë dhe incidenti ndërmjet Drejtorit të Teatrit Kombëtar dhe gazetarit Eni Shehu, e cila degradoi në fyerje e dhunë. Të dyja palët e përfshira në këtë incident kanë dhënë opsionet e tyre mbi situatën dhe faktorët që nxitën sulmet fizike, publikisht por ajo që ne dimë është se pavarësisht rrethanave asnje prej fukcioneve të dy personazheve nuk legjitimon dhunën në çdo kontekst. Interesant mbetet qëndrimi edhe i vetë titullares së MK e cila në diktatimet publike, nuk dënonte këtë akt të shëmtuar, por mbronte me fanatizëm vartësin e saj. Ajo që nënkuptojmë nuk është braktisja e kolegëve, por fakti që Ministrja Kumbaro në asnjë moment nuk tërhoqi një vërejtje ndaj titullarit të Teatrit Kombëtar, qoftë edhe në kontekstin e një "formalizmi publik". Cilatdo të kenë qenë rrethanat, reagimi i tij në vendin e punës, në pikun e frekuentimit gjatë eventit teatral, nuk është i tolerueshëm sepse asnjë status nuk ia jep të drejtën e ushtrimit të dhunës, kjo edhe në raste provokimi të qëllimshëm. Ajo çka kuptojmë nga këto qëndrime është se "funksioni" të jep të drejtë për gjithçka dhe për mosndëshkim. Ngjarje të tilla cënojnë integritetin e vetë personit, insitucionit të cilin ai drejton dhe më tej të titullarëve që ndonjëherë detyrohen të mbajnë përgjegjesi publike mbi vendimet e marra në funksion të menaxhimit insitucional. Ndaj çdo gjë mund të ishte lënë "pas shfaqjes", për mos prodhuar

“show” dhe shfaqje në të njëjtin orar, sikurse ka edhe forma të tjera në baze të rregulloreve që mund të zgjidhnin këtë situatë dhe ndërhyrjen e menjëhershme duke larguar nga salla personat që mund të shkelin këto rregullore, po aq sa edhe këto rregullore parashikojnë edhe largimin apo masat administrative për funksionarë apo nënpunës të cilët kryejnë shkelje të rënda.

Dhe sikur të mos mjaftonte kjo, në muajin shkurt Ministria e Kulturës kthehet sërish në vëmendjen publike me një tjetër ngjarje që shkaktoi reagime dhe debate të gjera në lidhje me një tjetër artist të njohur shqiptar. Këtë herë flasim për piktorin Ibrahim Kodra, i cili nuk jeton më dhe prehet në varrezat e fshatit Ishëm, për të cilin ishte ideuar një ceremoni nderimi duke shpërngulur dhe vendosur eshtrat e tij pranë parkut të Liqenit Artificial me pretendimin e përmbushjes së amantetit të tij sipas kërkesës së Fondacionit Ibrahim Kodra. Kjo nisëm revoltoi banorët e fshatit Ishëm, të cilët u ngritën duke mos lejuar këtë veprimtari, dhe duke denoncuar vertetësinë e disa deklaratave të MK. Ku sipas raportimit të tyre thuhej se MK-së ka deklaruar se për këtë nismë është marrë dhe mendimi i banorëve të zonës nëpërmjet bashkëbisedimit, ndërkohë që ata shprehen se kjo gje nuk ka ndodhur dhe nuk ishin në dijeni. Atëhere nëse ky amanet ekziston përse duhe te vijë si kërkesë nga Fondacioni dhe për zbatimin e tij duhet të ndërtohet një projekt e më tej të merret edhe mendimi i banorëve të zonës? (Sipas lidhjes logjike në bazë të deklaratave publike).

A mos vallë vete insitucioni më i lartë i Kulturës në shqipëri tentoi të shkelte mbi një amanet, element kryesor i traditës tonë kulturore shpirtërore?

Në lidhje me këtë ngjarje reagues dhe shumë artistë të njohur në fushën e arteve pamore të cilët kanë pasur rastin ta njohin apo dhe te jenë miq të tij, të cilët e mbyllën fjalën e tyre me frazën “e kush na pyet ne artistëve” çtë flasim, nuk është konsultuar njeri me ne. Ndërkohe prof. Gazmend Leka jep edhe një deklaratë gojore “siç lihet dhe amaneti”, ku tregon momente nga bisedat me I. Kodrën, sipas të cilit shprehimisht ka thënë që eshtrat e mia dua të shlodhen në Ishëm, të shoh det e të jem mes natyrës në vendlindjen time. Nga nje tjetër kendvështrim, një nismë e tillë do ta nxirrte jashtë kontekstit edhe vetë varrin monument të I. Kodrës pasi në Parkun e Liqenit në Tiranë vërtetë gjejmë shtatore figurash të shquara e varre angleze apo francezësh, por vetë funksioni i këtij parku do ta linte totalisht jashtë vëmendjes varrin e një personaliteti të tillë, ku edhe ata pak bashkëfshatarë që mund ta vizitojnë herë pas herë apo farë e fis i afërt e i larget nuk do të kishin të njëjtat kushte e mundësi. Sikurse do të ishte më mire që prania e kaesaj figure në Ishëm ta kthente zonën në një qendër vemendje duke krijuar projekte që të afrojnë të interesuarit te artisti dhe varri monument i tij, jo të transferojmë artistin bashkë me mermere që s’flasin në qendrat më të populluara. Pas debateve të shumta, për mungesë edhe të vërtetimeve të dokumentuara me shkrim mbi rastin në fjalë, si dhe rezistencës së debatit përballë të afermve e banorëve të Ishmi-t, Ministria e Kulturës vendosi, fillimisht, shtyerjen e ceremonisë së nderimit dhe më tej anulimin e zhvarrimit të artistit.

3. Projektet fituese 2016

Pas thirrjes së radhës për projekt propozime në Art, Kulturë dhe/ose Trashëgimi për vitin 2016 në muajin dhjetor 2015, në muajin shkurt, shpallen 92 projektet fituese të këtij viti. Referuar raporteve të mëparshme dhe publikimeve nga MK, kuptojmë se Ministria e Kulturës, ndryshe nga viti i shkuar trajtoi në një thirrje të përbashkët thirrjen për projekte në art, kulturë e trashëgimi, të cilat vitin e kaluar u trajtuan në thirrje të ndryshme.

Vitin e kaluar shuma që mund të financohej nga M.K ishte deri në 3.500.000 lekë të reja, ndërsa këtë vit, 2.500.000 lekë të reja. Pra kemi një rikthim në financimin e projekteve me fonde të njejta si në vitin 2014.

Gjatë vitit 2015 u shqyrtuan 300 projekt-propozime dhe u perzgjodhen 82 projekte fituese.

Ndërsa këtë vit MK ka shqyrtuar rreth 212 projekte dhe ka përzgjedhur 92 projekte fituese. Nga këto 20 projekte shkojnë për artistët e rinj, (individë) një hap pozitiv.

Në listen e projekteve të përzgjedhura, tashmë e publikuar në faqen zyrtare të MK gjejmë të renditura: titujt e projekteve, gjininë, dhe emrin e subjektit përfitues. Ajo që të bën përshtypje është sikurse në vitin e shkuar mungon evidentimi i granteve të përfituara nga këto subjekte për ta bërë sa më transparent procesin e financimit. Publikimi i fundit i granteve të përfituara për çdo projekt fitues daton në vitin 2014.

Për ta bërë sa më transparent të gjithë procesin e përzgjedhjes dhe për te rritur besueshmerinë ndaj vendimmarrjes së MK, do të kishte qënë më e drejtë që të

ishte publikuar lista e të gjithë aplikantëve para procesit vlerësues dhe më tej vetëm lista e fitueseve (e publikuar) së bashku me grantin e përfituar. Kësaj do t'i shtonim dhe publikimin e një paragrafi përmbledhës nga ku të përshkruhej natyra dhe aktivitetet që parashikohet të realizohen gjatë implementimit të tyre, përfshirë harkun kohor.

Referenca:

<http://www.albeu.com/shqiperi/skandal-hervin-culi-godet-gazetarin-e-abc-news/228100/>

<http://www.panorama.com.al/flet-hervin-culi-ja-e-verteta-e-sherit-me-gazetarin-neteater/>

<http://www.mapo.al/2016/01/skandal-neteatin-kombetar-drejtori-culi-rreh-gazetarin-e-abc-news>

<http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/lajme/thirrja-per-projekt-propozime-2016-projektet-e-perzgjedhura-per-mbeshtetje-ne-art-kulture&page=1>

<http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/lajme/ibrahim-kodra-memorial-per-mjeshtrin&page=2>

<http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/lajme/prezantohet-projektligji-per-te-drejten-e-autorit-dhe-te-drejtat-e-tjera-te-lidhura-me-te&page=2>

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=318104>

<http://www.mapo.al/2016/02/ministria-e-kultures-shtyn-ceremonine-e-rivarrimit-te-kodres>

<http://tvklan.al/eshtrat-e-ibrahim-kodres-nuk-do-te-zhvarrosen/>

<http://appa.al/raport-dhjetor-2015-ministria-e-kultures/>

MINISTRIA E MBROJTJES

Brenton KOTORRI, BA

1. Ushtria ndërton ura

Në kuptimin e parë të fjalës, ushtria shqiptare është angazhuar që në fillim të këtij viti me ndërtimin e 3 urave të tipit "Bailey" mbi lumenj që ndajnë dy fshatra në Skuraj, në Çermë, e në Qeha. Urat janë sigurisht një mjet i rëndësishëm për lëvizjen e popullsisë për arsye të ndryshme. Duke filluar që me udhëtimin e fëmijëve çdo mëngjes drejt shkollave, por gjithashtu edhe me dërgimin e produkteve të fshatarëve në tregun e qytetit. Sigurisht që kudo në botë, në raste emergjencash ushtria ndërhy duke ndërtuar ura të tilla, apo duke ndihmuar në raste përmbytjesh. Mirëpo njëkohësisht me këtë lëvdatë që duhet t'i bëjmë forcave tona të armatosura, duhet të theksojmë atë që nuk e thotë njeri: Kjo qeveri ka hequr dorë nga çdo projekt infrastrukturor për zhvillimin e fshatrave dhe nuk ka paraqitur në planet e veta të 2016-ës, ndërtimin e ndonjë ure të tillë. Ndaj, nëse deri dje për qytetarët e këtyre fshatrave gjysmë të izoluara kujdesej qeveria, sot kujdeset ushtria. Zgjidhja do të ishte që forcat tona të armatosura të mos përdreshin më për të pastruar mbetjet urbane e për të mbajtur në kurriz bagëtitë gjatë

përmbytjeve, por të trajtohen me paga më të mira, me kushte më të mira, dhe sidomos me dinjitetin e të gjithë sivëllezërve të tyre në ushtritë e tjera pjesë të NATO-s.

Në fakt, gjatë gjithë muajit, ministrja Mimi Kodheli ka ndërmarrë një tur ku takimet kryesore i ka pasur me nxënës të gjimnazeve duke tentuar që t'i rekrutojë ata në forcat e armatosura. Kjo nismë duhet përgëzuar, me siguri. Mirëpo ajo që ministrja harron, është problemi i madh që ka ushtria shqiptare: ajo ekziston në kushte të tmerrshme. Përmes gjithë raportimeve tona të vitit 2015, ne kemi evidentuar në appa.al jo pak herë, këto kushte.

- 1- Ministrja nuk u thotë gjimnazistëve dhe qytetarëve të Shqipërisë se pagat e personelit ushtarak në vend që të rriten me hyrjen në NATO janë ulur në fakt.
- 2- Ministrja nuk u thotë atyre se kushtet e punës në forcat e armatosura janë të njejta me ato të kohës së komunizmit dhe ndryshojnë vetëm uniformat e reja si gëlqerja e re e mureve të godinave, por asgjë tjetër.
- 3- Ministrja nuk u thotë qytetarëve se administrata që ajo drejton nuk ishte përfolur prej vitesh për vjedhje e korrupsion por ama rezulton se ka shkaktuar dëm ekonomik në raportin

e KLSH. Dhe për ta mbështetur këtë do të sjellim një pasazh prej raportit tonë të muajit nëntor 2015: *"Për hir të vërtetës, Ministria e Mbrojtjes që prej shtatorit të vitit 2013 nuk ka bërë bujë në media dhe arenën publike për raste të evidentuara korruptive. Në fakt, në raportet përmbledhëse të Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitet 2013 dhe 2014 Ministria e Mbrojtjes nuk reshtohet ndër institucionet publike që i kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit. Megjithatë në Buletinin numër 3 të vitit 2015, botuar nga KLSH, vihet re se prirja ndryshon dhe konstatohen shkelje me dëm ekonomik në fushën e prokurimeve që kap vlerën 129 700 000 leke . Në fillim të këtij muaji Kontrolli i Lartë i Shtetit lajmëroi kallëzimin penal ndaj disa punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes. Sipas raportit të KLSH dëmi ekonomik që i është shkaktuar buxhetit të shtetit është rreth 942 000 Euro, afërsisht pagën mujore të 6280 shqiptarëve (nëse e llogarisim atë në masën e pagës minimale). Vetëm në një institucion, në një kontroll auditimi për një periudhë shumë të limituar kohorë, dëmi ekonomik është baraz me heqjen e pagës 1 mujore të 6280 njerëzve".*

4- Ministrja nuk u thotë atyre se karriera e tyre në fushën akademike të

Çështjeve të Sigurisë, Studimeve të Terrorizmit, Mbrojtjes, apo Marrëdhënieve Ndërkombëtare, është totalisht e pasigurt pasi ministria asnjëherë nuk ka publikuar thirrje për shkollim të mëtejshëm por sipas raportimeve në media shpeshherë e nga denoncimet e ish-ushtarakëve, i ka fiksuar bursat dhe shkollimet si ndere personale.

2. Grekët

Në mes të muajit janar u raportua se një anije e rojës bregdetare greke pati tentuar të intimidonte një peshkarexhë shqiptare duke i komunikuar kapitenit të kësaj të fundit se ishin duke lundruar në ujërat territoriale greke. Pas mbërritjes në vendngjarje të rojës shqiptare, u konstatua se anija greke kishte nisur të largohej, dhe se në fakt ajo shqiptare kishte qenë brenda kufirit detar. E gjithë kjo ngjarje nuk u trumbetua shumë në media, mirëpo as zyrtarisht. Kjo do të thotë se qytetarët dhe biznesmenët shqiptarë të këtij lloji, mund të hasin gjithnjë situata të tilla dhe grekët të largohen gjithnjë "pa u lagur" si në këtë rast. Nuk ka asnjë kontaktim të derimëtanishëm, asnjë deklaratë e mëtej asnjë notë proteste nga ana e Ministrisë sonë të Mbrojtjes, apo Ministrisë sonë të Punëve të Jashtme për të dënuar të tilla provokime. Ne

sugjerojmë që në asnjë rast të mos tolerohet provokimi i hapur dhe presionimi i asnjë qytetari të lirë shqiptar, dhe ashtu sikurse e detyron kushtetuta, shteti të mbrojë dhe garantojë lirinë dhe jetën e secilit qytetar të vet. Reagimi duhet të kishte qenë zyrtar dhe i menjëhershëm.

3. Hapadollapa

Më 1 shkurt, Ministria e Mbrojtjes nxjerr në ankand disa tipe avionësh: Jak - 18 (6 copë), Mig - 15 (3 copë), Uti - Mig (3 copë), Mig - 17 (4 copë), Uti - Mig 17 (4 copë), Mig - 19 (10 copë), Mig - 21 (6 copë) dhe helikopterë Mi - 4 (4 copë). Vlera fillestare e të gjitha këtyre njësive që do të shiteshin me kushtin për të mos u ripërdorur për arsye ushtarake, ishte 61'400'000 Lekë. U ftuan të gjithë të interesuarit për të marrë pjesë në ankand. Për shitjen e këtyre mjeteve fluturuese të ushtrisë sonë, nuk u dha ndonjë shpjegim më i gjatë se pse ato duhen shitur, a ka ndonjë analizë teknike që përcakton se ato janë tashmë të panevojshme për ushtrinë tonë etj., por e gjitha kjo u fsheh nën etiketimin "për interes publik..." Paradoksi shkon edhe më tej kur më datë 15 shkurt, ankandi u anulua, dhe shitja u tërhoq pas. Kjo sërish pa ndonjë shpjegim më të gjerë sesa togëfjalëshi "... për interes publik".

Kërkojmë nga ministria të na sqarojë se si në logjikën e tyre, shitja e pastaj mos-shitja e këtyre avionëve janë njëkohësisht për interes publik.

Referenca:

Faqja zyrtare e Ministrise se Mbrojtjes

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/n-eesroom/lajme>

Roja bregdetare greke intimidon peshkarexhen shqiptare.

<http://vizionplus.al/anija-greke-shkel-territorin/>

Raportet e 2015-es per Ministrine e Mbrojtjes

<http://appa.al/ministria-e-mbrojtjes/>

Hapet Ankandi per shitjen e Avioneve e helikoptereve

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/n-eesroom-2/njoftime/1564-ankand-publik-avione-dhe-helikoptere-per-perdorim-jo-ushtarak>

Lista e ankandit

http://www.mbrojtja.gov.al/images/njoftime2016/ankand_avion_helikopter_shkurt_2016.pdf

Mbyllja e ankandit

MINISTRIA E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Ingrid Xhafa, MA

Fillim viti 2016, e ka gjetur Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe të Rinisë (MMSR) të angazhuar në disa fusha, por çështja kryesore që ka përcaktuar axhendën e Ministrit Klosi për 2 muajt e fundit ka qënë padyshim Programi Kombëtar i Punësimit. Në kushtet ku çështja e punësimit është konsideruar dhe trajtuar si një nga problemet kryesore të vendit gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, vëmendja e qeverisë shqiptare dhe veçanërisht e Ministrisë së Mirëqenies Sociale ndaj punësimit, vlen për t'u përshëndetur. Megjithatë, ndryshimet përkatëse në legjislacion, politikat e ndërmara në këtë kuadër, deklaratat për shtyp, prezenca e lartë e vetë Ministrit dhe zyrtarëve të ministrisë në zyrat e punësimit, takimet me sipërmarrës në gjithë territorin dhe daljet e shumta televizive, ende presin të faktorizohen në rritje të nivelit të përgjithshëm të punësimit në vend, gjë që deri më sot nuk dokumentohet të ketë ndodhur. Kështu, statistikat nga INSTAT për tremujorin e tretë të 2015-tës vazhdojnë të tregojnë se niveli i papunësisë është ende i lartë me 17,5 % të grupmoshës aktive dhe 32, 3% për të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç. **Shifrat e fundit numërojnë rreth 226, 281 të papunë Shqipëri** (INSTAT, Dhjetor, 2015).

Por, pavarësisht nivelit shumë të lartë të papunësisë, sidomos te të rinjtë, qeveria shqiptare dhe MMSR-ja si pararojë, kanë ndërmarrë një fushatë intensive të promovimit të programeve të nxitjes së punësimit, ku argumentojnë se shkaku

kryesor i papunësisë në Shqipëri nuk është te mungesa e vendeve të lira të punës, por te mungesa e profesionistëve, që nënkuptohet si mugesë e kapaciteteve dhe aftësive të forcës punëtore në vend. Gjithashtu, **Ministri Klosi pretendon që në 2 vitet e fundit janë punësuar rreth 200 mije persona** dhe se sipërmarrja vazhdon të ofrojë vende të lira pune, por nuk arrin të gjejë profesionistë. Në këtë drejtim, janë ndërmarrë nisma të forcimit të arsimit dhe trajnimit profesional, për t'iu përgjigjur kërkesave të biznesit.

Megjithatë, raporti i fundit (Prill 2015) i grupit të Bankës Botërore mbi Analizën Sistematike që i bëhet vendit, fokusuar thelbësisht mbi performancën socio-ekonomike, nuk e përmend mungesën e kapaciteteve të forcës punëtore si shkakun kryesor të papunësisë, por e lidh këtë me situatën e vështirë ekonomike të vendit. Kështu, një ekonomi me ritme të ngadalta rritjeje, me një borxh publik që është rritur me 15 % në 7 vitet e fundit, me politika fiskale të dobëta dhe kontroll të ulët ndaj menaxhimit të financave, është shkencërisht e pamundur të gjenerojë vende të reja pune. Sigurisht kjo nuk e përjashton faktin që mund të ketë mospërputhje mes kualifikimeve të fuqisë punëtore dhe kërkesave specifike të tregut, një fenomen që është prezent edhe në vendet më të zhvilluara të botës.

Në përgjithësi, ky raport nuk synon të argumentojë kundër programeve të nxitjes së Punësimit, që konsiderohen prioritare nga qeveria shqiptare dhe që kanë filluar të zbatohen nga MMSR-ja. Megjithatë, siç është vënë në fokus dendur nga shtypi, apo ekspertë të fushës, qasja e qeverisë në përgjithësi

dhe e Ministrisë në veçanti në trajtimin e forcës punëtore si joprofesioniste dhe "dembela" është e papërshtatshme dhe në thelb diskriminuese. Pavarësisht skemave dhe programeve që janë ndërmarrë në nxitje të arsimit dhe trajnimit profesional në përputhje me kërkesat e tregut, nevojitet një qasje rigoroze, racionale dhe sistematike në adresimin e çështjeve të punësimit në vend. Kjo qasje duhet të jetë në kontrast me politikën e bazuar mbi opinione (*opinion-based policy*), e cila mbështetet kryesisht në pordorimin e fakteve selektive (pavarësisht cilësisë) ose në pikëpamjet e paprovuara të individëve apo grupeve të caktuara, të cilat janë shpesh të frymëzuara nga pikëpamje ideologjike, paragjykime, ose hamendje spekulative. Në këtë rast, konsultimi vetëm me grupet e interesit (sipërmarrës të ndryshëm) nuk është indikator i mjaftueshëm, në përcaktimin e qasjes institucionale ndaj problemit të punësimit në vend.

Për më tepër, mbështetja institucionale ndaj programeve specifike të trajnimit profesional duhet bazuar në një studim të mirëfilltë të tregut, kërkesave dhe ofertave për punë, përtej studimit të pjesshëm që gjendet në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020. MMSR-ja duhet ta shtrijë këtë qasje edhe në sistemin e arsimit formal, ku kurrikula dhe orientimet për karrierën, të bazohen në studime të mirëfillta dhe të përditësuara të tregut. Gjithashtu, ministria dhe agjensitë e varësisë duhet të forcojnë skemat e ndërveprimit me punëdhënësit, të cilët duhet të ofrojnë kontribut real në ofrimin e kurseve dhe trajnimeve, përveç se të kërkojnë një fuqi punëtore të kualifikuar sipas nevojave të tyre specifike. Një

platformë inkurajuese ndërlidhëse në këtë drejtim do të ishte edhe ajo mes sipërmarrësve dhe studentëve, ku ministria/organet varëse mund të lehtësojnë ngritjen e skemave mbështetëse, ku studentët incentivohen nëpërmjet bursave të nevojës apo meritës në programe specifike studimi, që mbulojnë financiarisht nga grupet e biznesit.

Zv. Ministria Gentiana Mara (Sula) është shprehur se ndër të tjera, **një nga arsytet e papunësisë lidhet me varësinë e krijuar nga skemat e solidaritetit që ka në Shqipëri**, e lidhur kjo kryesisht me pagesën e papunësisë apo ndihmën ekonomike. Nuk dihet nëse këto gjetje kanë një natyrë studimore dhe çfarë metodologjie është përdorur për të arritur në këtë përfundim, por është e udhës të përmendet se **skema e ndihmës së papunësisë është më pak se 7 mijë lek në muaj, ose afërsisht 2\$ në ditë, që njihet edhe si niveli ndërkombëtar i varfërisë sipas Bankës Botërore**. Kurse **ndihma ekonomike** varion në mënyrë të diferencuar për secilën kategori, duke filluar nga 900 lek në muaj për anëtar të familjes më të vegjël se 18 vjeç, deri në 1 mijë e 800 lek/muaj për kryefamiljar, dhe se **nuk mund të shkojë më shumë se 7500 lekë në muaj për familje, pavarësisht numrit të anëtarëve të familjes**. Duke konsideruar vlerën e këtyre të ardhurave, është e vështirë të besohet, se njerëzit preferojnë të kultivojnë varësi ndaj skemave të ndihmave ekonomike apo pagesës së papunësisë, që i lënë në kushtet e një varfërie ekstreme, në vend që të kërkojnë punë në mënyrë aktive. Nga ana tjetër, mund të jetë e vërtetë që

ndodhin abuzime me skemat e solidaritetit, si favorizimi i asaj që njihet si puna në të zezë, ku punëkërkuessit mund të mos deklarohen në organet tatimore në rast punësimi, në mënyrë që të vazhdojnë të përfitojnë padrejtësisht nga skema e ndihmave. Megjithatë këshillohet të forcohen mekanizmat e kontrollit që këto raste mos të ndodhin, në vend që të përdoren instrumenta të tilla ligjore siç është rasti i përjashtimit nga skema e punëkërkuessit në rast se punëkërkuessi refuzon punën e ofruar apo kurset e formimit profesional qoftë edhe njëherë të vetme.

Konkluzioni i përgjithshëm nga studimi i funditi Bankës Botërore, thotë se në Shqipëri ekziston një lidhje e fortë mes rritjes ekonomike dhe zbutjes së varfërisë. Duke analizuar këtë lidhje, dhe konsideruar politikat e shumta ndërministrore, sygjerohet që MMSR-ja të konsolidojë lidhjen ndër-institucionale me ministrinë e tjera, sidomos me atë të Financave, Ministrinë e Ekonomisë, Arsimit, Drejtësisë etj. jo vetëm në forcim dhe harmonizim të kuadrit të politikave, kuadrit ligjor dhe institucional, por edhe në hartimin planeve të përbashkëta të veprimit. Programet e trajnimit profesional, edhe pse të domosdoshme, nuk duhen trajtuar si zgjidhje shteruese të problematikave që lidhen me punësimin në Shqipëri.

Referenca:

<http://www.sociale.gov.al/>

[http://www.instat.gov.al/media/318434/atfp_t3 - 2015.pdf](http://www.instat.gov.al/media/318434/atfp_t3_-_2015.pdf)

(<http://www.reporter.al/ep-content/uploads/broshure-EB-1.pdf>)

[http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/15-01-14-02-54-53Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi,_Plani_Veprimit_24_11_2014_\(KM\).pdf](http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/15-01-14-02-54-53Strategjia_Kombetare_per_Punesim_dhe_Aftesi,_Plani_Veprimit_24_11_2014_(KM).pdf)

<http://www.gazetadita.al/intervista-vente-pune-ka-por-mungojne-njerezite-afte/>

MINISTRIA E MJEDISIT

Flutura GJANA, MSc.

1. Plani kombëtar i Energjisë së Rinovueshme ndihmon në shkatërrimin e biodiversitetit

Më 27 janar, në fletoren zyrtare të Republikës së Shqipërisë²² u botua VKM nr.27 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimt për Burimet e Energjisë së Rinovueshme, 2015-2020". Një nga objektivat e këtij plani kombëtar është ai i rritjes së burimeve të rinovueshme që shfrytëzohen për gjenerimin e energjisë totale që vendi ynë shpenzon përgjatë një viti nga 31.2% që ka qenë në vitin 2009, në 38% në vitin 2020.

Në pamje të parë, ky plan nuk lë asnjë hapësirë për diskutim për shkak të rëndësisë që ka energjia e përftuar nga burime të rinovueshme në ditët e sotme. Por sasia e energjisë që duhet të përftohet nga burime të rinovueshme në sektorin e energjisë elektrike lë shteg për diskutim. Siç mund të shikojmë në tabelën e mëposhtme, për sektorin e energjisë elektrike pritet që 25% e saj të përftohet nga burime të rinovueshme. Shfrytëzimi i hidrocentraleve për të përftuar këtë energji zë peshën më të madhe, përkatësisht me 18.5 %.

Burime të Përfutimit të Energjisë Elektrike	Sasia që do të përftohet
HEC	18.5%
Eolike	2.8%
Fotovoltaike	3.7%

²²FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, 27 janar 2016
http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/7-2016.pdf

Totali	25%
---------------	------------

Koha ka faktuar impaktin negativ që ka në mjedis ndërtimi i hidrocentraleve në një shtet si Shqipëria, institucionet e së cilës nuk janë të zotë apo nuk duan të ndjekin dhe të kontrollojnë projektet e hidrocentraleve që nga faza e analizës së projekteve përpara se të merret vendimi për t'i ndërtuar, e duke vazhduar me fazën e prodhimit apo fazës së mirëmbajtjes.

Hidrocentralet janë kërcënim për rivierën shqiptare dhe për ekologjinë e lumenjëve. Ndërtimi i shumë hidrocentraleve në një kaskadë do të sillte deformimin e rrjedhjes së lirë të lumenjve, si rrjedhje riviera përgjatë bregdetit do të pësojë ndryshime.

Dy lumenjtë më të kërcënuar janë pikërisht Devolli dhe Vjosa, dhe për aq kohë sa më shumë hidrocentrale do të ndërtohen në zona me vlera ekologjike të larta, dëmi i pritshëm për ekosistemin e lumenjëve do të jetë veçanërisht i lartë. Edhe Fragmentarizimi i lumenjve me diga çon drejt degradimit afatgjatë të sistemit të lumit.

Rikujtojmë se në korrik të 2015 kryeministri ka deklaruar se lugina e Vjosës do të kthehet në zonë të mbrojtur²³, por faktet tregojnë të kundërtën. Në fletoren zyrtare thuhet se "Zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik është planifikuar kryesisht përgjatë lumenjve Mat, Vjosa, Devolli dhe Bistrica". Për të mos

²³ Deklarata e Krzeministrit Rama për lumen Vjosa, video min. 00:39
<https://www.youtube.com/watch?v=06RlLylFU5>

mjaftuar, më 10 shkurt, në media ²⁴ është bërë publik lajmi nga zëvendës ministri i Energjitikës, se ka një studim nga një studio e huaj për të pasur 9 hidrocentrale në rrjetin e lumit Vjosa.

Është e rëndësishme të tregohet shumë kujdes ndaj çdo politike që prek lumenjtë dhe ekosistemin e tyre, pasi ata janë një nga pasuritë më të mëdha që ka ky vend. Edhe pse infrastruktura dhe hidrocentralet, apo përdorimi i burimeve të rinovueshme për të përfutur energji janë të rëndësishme për të plotësuar direktivat europiane, edhe biodiversiteti dhe ruajtja e ekosistemit është vlerë për gjithë Evropën.

Janë pikërisht projekte të tilla që parashikohen të ndërtohen në zona të mbrojtura, të cilat i japin energjisë sërinovueshme një emër vërtet të keq. Shqipëria ka më shumë se 260 ditë me diell në vit, pra një mundësi shumë e mirë për të shfrytëzuar energjinë diellore si energji alternative. Do të ishte e udhës që për të arritur përmbushjen e këtij plani kombëtar, strategjia të fokusohet pikërisht tek energjia diellore dhe përdorimi i paneleve fotovoltaike, një teknologji e pastër për të përfutur energji. Përdorimi i këtyre paneleve përbën interes si për koston e ulët financiare ashtu edhe për impaktin e ulët negativ që kanë në mjedis, i cili është pothuajse zero²⁵.

²⁴Artikull: 9 diga mbi Vjosë, qeveria prezanton projektin mes protestave ambientaliste (<http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=319256>)

²⁵ Artikull: Environmental Impacts of Solar Power- (http://www.ucsusa.org/clean_energy/our-energy-choices/renewable-energy/environmental-impacts-solar-power.html#.VtQCg1srKM8)

2. Mbetjet urbane shkojnë deri tek fqinjët

Mbetjet urbane të Shqipërisë, një problematikë që ka kaluar kufinj të dhe po shqetëson edhe fqinjët tanë. Eurodeputetja kroate i është drejtuar²⁶ Komisionit Evropian për të gjetur një zgjidhje për plehrat shqiptare që kanë mbytur bregdetin kroat.

Nga Ministria e Mjedisit akoma nuk është dhënë një prononcim se sa me vend është ankesa e eurodeputetes. Por realisht MM nuk ka bërë asgjë në lidhje me problematikën e mbetjeve urbane që ka vendi.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar në procesin e anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian dhe për këtë qëllim Ministria e Mjedisit ka punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit shqiptar në përputhje me instrumentet legjislativë të BE-së. Legjislacioni Shqiptar për menaxhimin e mbetjeve është përmirësuar me ligje të reja, vendime e rregullore që reflektojnë, direktivat e BE-së dhe detyrimet nga Konventa e Bazelit. Akti i fundit në këtë fushë mban datën e 29 korrikut²⁷ të vitit 2015, Këshilli i Ministrave mori vendim "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve". Gjithashtu që në vitin 2010 është ndërtuar një Plan Kombëtar²⁸ për menaxhimin e mbetjeve urbane, por sot situata e menaxhimit të

²⁶Artikull: Shqetësim nga mbeturinat shqiptare, eurodeputetja kroate i anketohet KE-së (<http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=320390>)

²⁷Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 29.7.2015 (<http://www.mjedisi.gov.al/al/programi/mbetje-dhe-ndotje-industriale/mbetje>)

²⁸Plani Kombëtar i Menaxhimit të Mbetjeve (http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Mbetje/PKM_Mb_final.pdf)

mbetjeve është ende e paqartë dhe zgjidhjet akoma nuk janë të frytshme.

Por, problemi i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri nuk vjen si mungesë e ligjeve (që natyrisht kanë nevojë të përmirësohen edhe më tej), por si mungesë e planifikimit të burimeve njerëzore, financiare dhe investimeve në infrastrukturë, si mungesë e kapaciteteve teknike, e komunikimit të dobët midis qeverisë lokale dhe qendrore mbi çështjet e mbetjeve, bashkëpunimit të dobët midis autoriteteve lokale dhe kompanive private, si dhe mungesës së infrastrukturës së nevojshme për t'i mbledhur dhe për t'i përpunuar ato.

Politikat mjedisore në Shqipëri dhe vetë realiteti shqiptar, po përballen me një sërë problematikash dhe shqetësimesh të dukshme. Shqipërisë, përkatësisht qeverisë dhe Ministrisë së Mjedisit i mungon vizioni afatgjatë për të menaxhuar çdo aspekt që lidhet me mbetjet urbane.

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Megi LLUBANI, MSc

1. Vit i ri, reshje të reja!

Shqipëria e nisi vitin e ri sërish me përmytje. Ky nuk është një lajm që shkakton habi tek qytetarët. Këta të fundit janë mësuar tashmë me pamjet e qyteteve të tyre nën ujë pas reshjeve, sado modeste qofshin këto. Ajo që habit megjithatë dhe që ngre pikëpyetje për largpamësinë e politikbërësve të këtij vendi është qasja reaguese ndaj fenomeneve të tilla në vend të aplikimit të një qasjeje parandaluese.

Që në javën e parë përmytjet prekën disa qytete të Shqipërisë, përfshirë këtu edhe Tiranën, lumi i të cilës doli nga shtrati për të përmytur një pjesë të mirë të periferisë së kryeqytetit. Në datë 6 janar Ministri Tahiri u gjend në disa prej zonave të përmytura së bashku me Drejtorin e Emergjencave Civile për të mbikqyrur situatën dhe dëmin e shkaktuar. E njëjta situatë vijoi edhe në ditët në vazhdim. Problemi qëndron se situata të tilla përsëriten në pafundësi edhe me praninë e ministrit për të parë përmytjet. Çfarë po bën Ministria e Punëve të Brendshme për t'u siguruar se situata të tilla nuk kthehen në fatkeqësi natyrore të përmasave të mëdha edhe me reshje që përndryshe do të konsideroheshin me parametra të zakonshme për vende të tjera?

Niveli i parë i adresimit të një problemi publik është hartimi i politikave publike. Niveli i fundit është monitorimi dhe vlerësimi i impaktit të tyre në praktikë që mbyll ciklin e

politikbërjes. Në vitin 2014 Ministria e Brendshme duhet të hartonte Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile 2014-2018. Sipas Raportit të Komisionit Evropian të vitit 2015 deri në fund të vitit të kaluar kjo strategji ende nuk ishte miratuar dhe vijon të mos jetë e pranishme në portalet e ministrisë apo parlamentit. Për më tepër, në një deklaratë të një viti më parë Ministri Tahiri premtoi se brenda vitit 2015 do të ishte gati ligji i ri i emergjencave civile. Jemi në shkurt të vitit 2016 dhe asnjë prej dokumenteve ligjorë nuk i është paraqitur publikut apo parlamentit. Me këtë rast frojmë Ministrinë e Punëve të Brendshme të sqarojë publikun e interesuar për vonesat e pashpjegueshme në hartimin e këtyre dokumenteve të rëndësishëm. Krahasimisht, në këtë fushë Ministria duket se po vepron pa busull orientimi.

Sipas një raporti të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim mbi menaxhimin e emergjencave civile në morinë e problematikave të shtruara vihet re se 'Me gjithë progresin e Shqipërisë në menaxhimin e emergjencave civile, është e domosdoshme të bëhet më shumë për përsosjen e legjislacionit, koncepteve doktrinale dhe planeve zbatuese, përpërmirësimin e rolit dhe kontributit të çdo institucioni me përgjegjësi ligjore ndaj emergjencave civile, fuqizimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe krijimin e kapaciteteve të nevojshme për të përbërë një spektër të gjerë fatkeqësish natyrore apo të shkaktuara nga njeriu.²⁹

²⁹Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri.

2. Sa pushime nga puna para se Policia të punojë për qytetarët?

Në fund të muajit shkurt, u përsërit një ngjarje që është evidentuar edhe në raporte më të hershme të APPAs rreth punës së Policisë së Shtetit. Ministria e Punëve të Brendshme ka ndërmarrë një sërë masash në përpjekje për të modernizuar dukjen e Policisë së Shtetit përmes prezantimit të uniformave të reja dhe instalimit të kamerave të trupit. Ndërkohë që Ministria merret me anën kozmetike të punës së policisë së shtetit, thelbi mbetet në mos i pandryshuar, gjithsesi problematik. Skandali i goditjes së një protestuese gjatë manifestimit kundër ndërtimit të parkut të lojërave tek Parku i Liqenit tërhoqi vëmendje kombëtare edhe për faktin që protestuesi i goditur pa asnjë të drejtë ishte grua. Megjithë masat e menjëhershme të ndërmarra për largimin e punonjësit të policisë që ushtroi dhunë mbi një qytetar protestues, çështja thelbësore mbetet ende e pa adresuar. Kujtojmë se një prej premtimeve dhe pikave kryesore të programit qeverisës të Partisë Socialiste ishte modernizimi i forcave të rendit dhe ndryshimi i perceptimit të publikut për rolin e tyre në komunitet. Në këtë kuadër është aplikuar edhe qasja e policimit në komunitet dhe janë marrë masa të tjera që në raste të tilla të shkeljes së detyrës ngjajnë më tepër me përpjekje sipërfaqësore se sa adresimin e vërtetë të mungesës së etikës, shkeljes së ligjit dhe perceptimin se përgjegjësitë gjenden tjetërkund.

Online: <http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>

Një nga parimet themelore të integritetit policor është procesi i ankimimit dhe hetimi i shkeljeve të etikës së sjelljes. Sipas këtij parimi hetimet për sjellje të paligjshme duhet të zhvillohen nga një entitet që ka përgjegjësi speciale për kryerjen e hetimit. Për më tepër, hetimet për sjellje të paligjshme duhet të jenë të plota dhe të paanshme dhe të bëhen në mënyrë të përshtatshme dhe në kohën e duhur. Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të zhvillojnë udhëzime për hetimet e sjelljeve të paligjshme nga ana e oficerëve të policisë.³⁰

Referenca:

Faqja zyrtare e Ministrisë së Punëve të Brendshme në Internet. Online: www.punetebrendshme.gov.al

European Commission. 2015 Albania Report. Online: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_albania.pdf

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Menaxhimi i Emergjencave Civile në Shqipëri. Online: <http://idmalbania.org/ep-content/uploads/2015/03/Menaxhimi-i-Emergjencave-Civile-ne-Shqiperi.pdf>

³⁰Principles for Promoting Police Integrity. US Department of Justice. Online: <https://www.ncjrs.gov/pdffiles1/ojp/186189.pdf>.

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME

Sokol KONDI, MSc

1. Vizita e John Kerry dhe përdorimi praktik amerikan i Shqipërisë

Më 14 shkurt, ditën e Shën Valentinit, Sekretari Amerikan i Shtetit John Kerry, mbërriti për një vizitë zyrtare në Shqipëri, ku nuk ngurroi që të shprehte dashurinë që ekziston mes dy shteteve, si dhe dha garanci për një të ardhme më të begatë të përbashkët.

Përveç intensifikimit të marrëdhënieve Shqipëri-SHBA, që kanë hyrë në një nivel tjetër, pas nënshkrimit të partneritetit strategjik vitin e kaluar, dhe që u dëshmuar edhe nga vizita e mëpasme që zhvilloi ministri i Jashtëm, Z. Bushati në SHBA, ra në sy një rezultat konkret i "diplomacisë në veprim". Në fakt, pas vizitës së Kerryt, doli se Shqipëria ka pranuar që të strehojë në vendin tonë mbi 2.000 muxhahedinë iranianë, që konsiderohen si armiq apo terroristë nga Republika Islamike.

Ndaj një vendimi të tillë, pati reagime edhe nga Irani, ku gjesti u përshkruasi një mikpritje ndaj terroristëve.

Pasi pranoi që të asgjësonte armët kimike të regjimit të Bashar Al Assadit, gjë që u ndal vetëm nga revoltat e brendshme popullore, pranimi i mbi 2.000 qytetarëve të huaj që konsiderohen si terroristë nga shteti i tyre, dhe që asnjë shtet tjetër nuk kishte marrë përsipër t'i pranonte (ndoshta edhe për arsye diplomatike), e ka vendosur Tiranën zyrtare për të disatën herë në pozitat e nxënësit që zbaton me

përpikëri detyrat që i jep mësuesi, që në këtë rast janë Shtetet e Bashkuara.

Do të duhej një analizë dhe një raport specifik vetëm për këtë temë për të parë raportin kosto/oportunitet nga veprime të tilla të Shqipërisë, por nga një vëzhgim i shpejtë, akti i qeverisë së këtushme rezulton më tepër si një gjest i lartë "besnikërie", term që kryeministri Edi Rama e theksoi fort disa herë gjatë fjalimit të përbashkët me Z. Kerry, se sa ndonjë pragmatizëm praktik me përfitime për vendin. Në fakt, është e vështirë të thuash se Shqipëria i ka të gjitha parametrat e sigurisë për të menaxhuar në mënyrë të sigurt për jetën e qytetarëve të saj dhe për të shmangur pasoja të mundshme ndërkombëtare, 2.000 persona të akuzuar si terroristë nga shteti i tyre, në një moment kur vendi ynë në shumë raporte të ndërkombëtarëve, cilësohet si një vend me probleme të thella të brendshme, lidhur me demokracinë, luftën ndaj krimin të organizuar, korrupsionit, sigurisë, e kështu me radhë.

2. Një dashuri e "Rilindur" për Izraelin

Katër ditë pas vizitës së Z. Kerry, në Shqipëri mbërriti kryetari i Parlamentit (Knesset) të Izraelit Yuli-Yoel Edelstein. Kjo vizitë vjen rreth dy muaj pasi kryeministri Rama kreu një vizitë të rëndësishme zyrtare në Izrael, ku u nënshkruanmjaft marrëveshje me perspektivë për thellimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Gjatë pritjes që i bëri ministri i Jashtëm Bushati, Edelsteinitiu paraqit edhe logoja e re që do të simbolizojë marrëdhëniet Shqipëri-Izrael, e cila u përcaktua pas një konkursi të shpallur nga MPJ e vendit tonë. Sikurse mund të shihet, bëhet fjalë

për një intensifikim kontaktesh dhe përmirësim marrëdhëniesh mes dy vendeve, gjë që është vënë re rrallë me ndonjë shtet tjetër, me përjashtim të Shteteve të Bashkuara, së fundmi.

Shqipëria zyrtarisht është për zgjidhjen e dy shteteve për sa i takon konfliktit ndërmjet Izraelit dhe Palestinës. Disa muaj më parë shkaktoi habi fakti që Shqipëria votoi një nismë në OKB për ngritjen e flamujve edhe të vendeve jo-anëtare, mes të cilave ishte edhe Palestina. Kjo u interpretua nga opozita shqiptare si një devijim nga politika tradicionale shqiptare e atashuar pas asaj të Shteteve të Bashkuara lidhur me çështjen e Izraelit, por pak kush vërejti se mes shteteve jo anëtare të OKB-së subjekte të votimit në fjalë, ishte edhe Vatikani. MPJ dha garanci se nuk kishte asnjë devijim në politikën e jashtme shqiptare. Kjo, në fakt, ishte konfirmuar më së miri që kur në gusht të vitit 2014, ndryshe nga qëndrimi zyrtar i BE-së, Shqipëria nuk dënoi një sulm të ushtrisë izraelite në një treg, ku mbetën të vrarë mjaft civilë palestinezë. Disa media opozitare u orvatën gjithashtu të paraqisnin muaj më parë si një skandal dhe një tjetër provë se politika jonë e jashtme po e "braktiste" Izraelin, kur u raportua se në një takim në MPJ në Tiranë, ishin ftuar si përfaqësuesi i Izraelit, ashtu edhe ai i Palestinës.

Por edhe kjo tezë ra shpejt poshtë nga vizitat në nivel të lartë që shkëmbyen në vijim dy vendet.

Ndryshe nga Bashkimi European, që nxorri një rregullore nëpërmjet së cilës i kërkonte Izraelit që të specifikonte etiketat e produkteve që prodhoheshin në kolonitë e saj në territoret palestineze, duke ushtruar kështu një

formë trysnie ndaj Izraelit, për të lejuar krijimin e Shtetit të Palestinës, dhe kur shtete të BE si Franca dhe Suedia e kanë njohur ose janë në proces njohjeje të shtetit të Palestinës, Shqipëria që e ka njohur Palestinën që më 1988 nga qeveria komuniste e atëhershme, është në kundër-tendencë dhe kundërshtim me frymën e politikës së jashtme të BE-së. Në fakt, neutraliteti dhe mosushtimi i asnjë forme trysnie të Shqipërisë ndaj Izraelit për të drejtën e Palestinës për të qenë një shtet e bën vendin tonë që të pozicionohet qartazi, ndryshe nga BE-ja, në linjë të plotë me Shtetet e Bashkuara në favor të shtetit hebre, për sa i takon mosmarrëveshjes historike në territorin delikat në Lindjen e Mesme.

Edhe në këtë rast, ashtu sikurse thamë më lart edhe për SHBA-të, zor se arsyet e kësaj "dashurie" mund ta kenë burimin te pragmatizmi apo te ndonjë vizion largpamës. Përkundrazi, shpjegimi i vetëm që mund të jepet është ai i politikës prej shteti të vogël që atashohet pas shpinës së një diplomacie të madhe botërore, sikurse është ajo amerikane në këtë rast.

Po të ishte për pragmatizëm, Shqipëria, e cila kryen mbi 70% të tregtisë së saj të jashtme me vendet e BE-së dhe që është përfituese direkte fondesh të konsiderueshme europiane për zhvillimin e saj, duke qenë se synon të integrohet në BE dhe jo në SHBA apo në Lindjen e Mesme, do t'i ishte ankoruar me kohë BE-së në qëndrimin e saj për këtë çështje. Sidoqoftë një politikë e tillë nuk cënon procesin integrues të vendit, por thjesht e bën alogjik dhe verbërisht besnik qëndrimin e vendit tonë, i cili, në vend që të mund të thoshte fjalën e tij, në harmoni me atë të BE-së për një çështje që prek shumë më nga pranë

Europën dhe kufijtë e sigurinë e saj se sa Amerikën, ka vendosur përkundrazi të përkrahë politikën amerikane për Izraelin, që është më shumë çështje strategjiko-gjeopolitike për fuqinë e madhe dhe pa ndonjë pasojë direkte përveç asaj morale të mosqenit në kauzën e duhur dhe kohën e duhur për Shqipërinë. Argumenta të mundshme të tipit: Palestina nuk njeh Kosovën dhe ka patur një afrim me Serbinë, dhe ndaj Shqipëria ka anuar nga Izraeli, mund të binin poshtë, nga momenti që as Izraeli nuk e njeh Kosovën dhe kur Shqipëria po bën vetë përpjekje afrimi me Serbinë. Në disa raste, Shqipëria është treguar "më katolike se Papa" madje me Izraelin. Pasi ndryshe nga qeveria Obama (por edhe OKB-ja), që i ka kërkuar disa herë dhe me tona të forta Izraelit që të ndalë urgjent ndërtimin e kolonive të reja në tokat palestineze, në bisedimet dypalëshe Shqipëri-Izrael, një çështje e tillë nuk është shtruar asnjëherë, duke ngritur dyshime të mëdha që Shqipëria të jetë vërtet për zgjidhjen e dy shteteve.

3. Diplomati të rinj, ves i vjetër

Në fillimin e muajit shkurt ministri Bushati i uroi mirëseardhjen dhjetë diplomatëve të rinj në shërbimin e jashtëm shqiptar, të cilët sipas tij u përzgjedhën në përfundim të një procesi konkurrimi të hapur dhe të bazuar në merita.

Mirëpo në faqen zyrtare të ministrisë së Jashtëme nuk ka asnjë njoftim për shpalljen e një konkursi të tillë.

Gjithashtu, nga organet e shtypit dhe mediat e ndryshme, nuk i është bërë reklamë apo jehonë eventit të hapjes së

një konkursi për vende të lira pune në shërbimin e jashtëm.

Edhe personat e regjistruar në sistemin e DAP për rekrutimet në administratë dhe që kanë shprehur interesin e tyre në opsionet përkatëse teknologjikenë fushënediplomacisë, bëjnë të ditur se nuk kanë marrë ndonjë njoftim për një vakancë të tillë në MPJ.

Me sa duket diplomatët e rinj, e kanë nisur me këmbë të "mbarë" karrierën, ndoshta jo për fajin e tyre, në bazë të një "vesi" tashmë të njohur për ne në MPJ, atë të mungesës së transparencës, sikurse e kemi raportuar vazhdimisht përgjatë vitit të kaluar.

4. Atentati në Ankara, Ministria e Jashtëme ia lë stafetën Mbrojtjes

Një atentat i rëndë që ndodhi në Ankara të Turqisë më 17 shkurt, ku u shënuan mjaft viktimë, edhe një tjetër herë shfaqti një mungesë të theksuar vigjilence nga ana e selisë diplomatike Shqiptare në Turqi apo edhe të vetë MPJ-së, për t'iu përgjigjur siç duhej rëndësisë së ngjarjes, sikurse do ta donte ligji dhe praktika e diplomacisë. Në fakt, as vetë ambasada jonë në Ankara dhe as sajti i ministrisë nuk kishin ndonjë referencë për sulmin e mundshëm terrorist në fjalë, kur dihet se në Turqi jetojnë, punojnë, apo shkojnë për turizëm mjaft shqiptarë.

Ambasadori i ri Gent Gazheli ndoshta ishte ende i paambientuar me detyrën e tij, duke qenë se e kishte marrë dekretin e presidentit Bujar Nishani vetëm në datën 9, ndërsa vetë ministria, si duket ia la dikasterit të Mbrojtjes, që të bënte një ekzaminim dhe pasqyrim të gjendjes së shqiptarëve që ndodheshin në Ankara, duke kryer kështu një këmbim të

pakuptimtë rolesh dhe detyrash. Trajtimii emergjencave nga ana e diplomacisë shqiptare vazhdon të mbetet larg praktikave dhe standardeve të diplomacive efikase botërore, sikurse mund të shihet në disa raporte te APPA të vitit të kaluar.

5. Politikë e jashtme në kaos. Tre zyrtarë të lartë thonë tre gjëra të ndryshme për të njëjtën çështje

Përveç muxhahedinëve iranianë, në Shqipëri mund të mbërrijë edhe një valë emigrantësh apo refugjatësh, që largohen nga zonat e luftës në Lindjen e Mesme, të cilët mund të strehohen në vendin tonë për një periudhë të papërcaktuar kohore.

Mirëpo, duke qenë se disa vende ballkanike apo europiane po ndjekin politika të ndryshme lidhur me hapjen apo mbylljen e kufijve, në varësi të interesave të momentit edhe Shqipëria shfaq një gjendje amullie për sa i takon politikës së jashtme të trajtimit të këtij fenomeni. Në fakt, ministrja e Integritetit Klajda Gjoshaj, Kryeministri Edi Rama dhe Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati, kanë shprehur tre qëndrime të ndryshme lidhur me çështjen e emigrantëve.

Ministrja tha se Shqipëria do t'i hapë kufijtë për emigrantët, kryeministri e mohoi një gjë të tillë, ndërsa ministri i Jashtëm as e pohoi dhe as e mohoi.

Si duket e vërteta duhet të gjendet në mes. Ose ndoshta, MPJ duhet të luajë një rol më efikas orientues dhe udhëzues kur vjen fjala për qëndrimet që duhet të mbajnë zyrtarët e lartë për sa i takon politikës së jashtme. Në ligj një gjë e tillë është shkruar qartë. Mbetet vetëm që të zbatohet.

Referenca:

Artikull, Top Channel, Shkurt, vizita e John Kerry në Tiranë: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=319495>

Artikull: Top Channel, Irani kundërshton marrhjen e muxhahedinëve nga Shqipëria: <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=319734>

Marredheniet Shqipërie-Izrael, MPJ, vizita e kryeministrit Rama në Izrael: <http://www.punetejashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/lajme/shqiperia-dhe-izraeli-thellojne-bashkepunimin-dypalesh&page=3>

MPJ, pritja e diplomatëve të rinj: <http://www.punetejashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/lajme/mpj-mirepret-gjeneraten-e-re-te-diplomateve&page=2>

Artikull, italisht, I"lufta" tregtare BE-Izrael për etiketat: <http://www.panorama.it/news/esteri/etic-hette-sui-prodotti-delle-colonie-israele-si-infuria-con-la-ue/>

Artikull, Mapo, shkurt, Ministria e Mbrojtjes raporton për atentatin në Ankara: <http://www.mapo.al/2016/02/shperthimi-ne-ankara-71-studentet-shqiptare-jane-mire>

Artikull, Monitor, Shkurt 2016, të dhëna mbi tregtinë e jashtme të Shqipërisë: <http://www.monitor.al/profili-ri-shqiperise-3/>

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Adela DANAJ, MA

1. Kryeqyteti (pseudo) evropian, pa shërbim urgjence. Modeli: Jashtë mode!

Lajmi për mbylljen e Urgjencës së Tiranës duke se ende nuk ka një përgjigje përfundimtare. Nga një anë qëndron pretendimi i mjekëve se ky shërbim do të mbyllet përfundimisht, ndërkohë nga krahu tjetër qëndron pretendimi i ministrisë së Shëndetësisë, ku flitet për një ristrukturim të këtij shërbimi. Mes lajmesh të mjegullta, ajo që bie më shumë në sy është pretendimi i mjekëve se kjo qendër do të mbyllet duke qënë se aty është planifikuar rishtazi të ndërtohet një pallat ose kjo qendër do të ketë të njëjtin fat si shumë shërbime të tjera mjekësore-do të jepet me koncesion.

Ministria e Shëndetësisë ka mbajtur një qëndrim zyrtar në lidhje me çështjen në fjalëmë datë 3 shkurt, ku flet për një ri-modelim të sistemit të shërbimit në kushtet e urgjencës me qëllimin e përmirësimit të cilësisë. Pra, sipas asaj që raporton ministria, kjo qendër nuk do të mbyllet por *do të shkrihet!* Nga kjo pikëpamje është e vështirë të interpretosh kuptimin dhe diferencën mes tyre, duke qënë se në të dyja rastet një gjë është e sigurt: personeli prej 61 personash që punojnë aty do të mbeten të papunë dhe 30 mijë kontrollet në vit që realizon kjo qendër duhet të kryhen diku tjetër. Dakord, po ku?

Pas petitionit të ngritur nga mjekët e kësaj qendre kundrejt kryeministrit Rama dhe ministrit Beqaj, ky i fundit dha një njoftim për shtyp kur ndër të tjera pohoi

se pretendimet e ngritura janë vetëm spekulime. Por këtu qëndron dhe marrëzia e radhës. Panvarësisht se gjithçka qenka spekulim, një gjë është e sigurt: "Urgjenca do të mbyllet pasi vetëm kështu mund të rritet cilësia"- Beqaj, shkurt 2016. Ndër të tjera ai foli dhe për procedurat teknike se si forma e re e shërbimit të urgjencës do të funksionojë, por ajo që ministri harroi të sqaronte lidhet me faktin se si do të mbulohet shërbimi i urgjencës gjatë kohës që do të ndodhë ristrukturimi.

Ndoshta pretendimi se gjatë kohës së ristrukturimit asnjë qytetar shqiptar nuk do të ketë nevojë të telefonojë urgjencën (dhe ashtu qoftë) ose pretendimi se ne do të telefonojmë shërbimet private spitalore, e ka bërë ministrin të mendojë se nuk është aspak e rëndësishme të ofrojë një shërbim alternativ gjatë kohës së ri-modelimit të strukturës së dalë mode tashmë. Pas një lumi akuzash të ngritura nga opozita për shpërdorim detyre dhe korrupsion në lidhje me dhënien me koncesion në mënyrë krejt të paqartë dhe aspak transparente të disa shërbimeve spitalore, Z. Beqaj duket se ka gjetur një formë krejt të re për të përmbushur urdhrat e marra me "vendim qeverie".³¹Për më tepër APPA ka qënë në ndjekje të vazhdueshme të çështjeve së padive dhe pretendimeve për afera korrupitve që janë hedhur mbi këtë ministri dhe në mënyrë të veçantë ndaj vetë ministrit Beqaj.³²Megjithatë, edhe pse skandalet e kësaj natyre duket se tani janë kthyer në pjesë të së

³¹Buletini i Muajt Dhjetor 2015. <http://appa.al/wp-content/uploads/2016/02/Buletini-APPA-dhjetor-2015.pdf> APPA 2015. Aksesuar: Shkurt 2015

³²Buletini i Muajt Tetor 2015. <http://appa.al/wp-content/uploads/2015/11/Buletini-Tetor-2015.pdf> APPA, 2015. Aksesuar: Shkurt 2016

përditshmes sonë, shqetësimi mbetet ende aty. Dhe pse ende nuk ka asnjë qëndrim zyrtar mbi çdo akuzë të ngritur kundrejt kësaj ministrie, ajo vazhdon të marrë vendime në kufijtë e skandalozes dhe atëherë kur flitet për një shërbim kaq emergjent siç është Urgjenca. Nuk dimë se kur do të ndalet vrapi i ministrit, por ne kërkojmë që ministria që ai mbulon të paktën të kujdeset për ato që kemi dhe të mos na heqë të drejtën e përdorimit të një shërbimi që duket të jetë jetik për nga pikëpamja e rëndësisë.

2. Sanitar? - Je i/e tepërt! Me pagën tënde do ngremë kala...

Sipas një studimi të realizuar nga Ministria e Shëndetësisë vetëm 1%-28% e shtretërve të vënë në dispozicion pranë qendrave spitalore në disa prej qyteteve të Shqipërisë shfrytëzohen. Pjesa tjetër e shtretërve qëndron aty pa u përdorur nga pacientët. Sipas këtyre të dhënave ministria në fjalë nuk del në konkluzionin se niveli i sëmundjeve ndoshta është ulur apo ka mos realizim me sukses të buxhetit paraprak apo planit të punës (dhe nëse është kështu, ka vend për përmirësim) por, duke qenë se shtretërit nuk shfrytëzohen mjaftueshëm, atëherë është koha të bëjnë disa ndryshime në shifra. Ne ulim numrin e shtretërve? Jo, ofrohet një zgjidhje më e shpejtë. Të largohen nga puna disa punonjës! Sipas kësaj logjike, në llogarinë e Ministrisë së Shëndetësië rezulton se qendrat e shërbimit mjekësor në disa prej qyteteve të vogla të Shqipërisë po shërbejnë momentalisht si qendra punësimi. Pa asnjë dyshim kjo mund të konsiderohet skandalozë! Ç'do të thotë që numri i shtretërve është më i madh se numri i pacientëve?! Është kjo një arsye për të ristrukturuar stafin?! Nuk do të ishte

logjikë më e shëndetshme nëse gjykonim se ato shtretër që janë tepër në një qytet të shkonin në një qendër tjetër ku ka mungesë shtretërisht? Mos ndoshta ministri duhet të merret me ata që hartojnë planet e punës apo buxhetin mbi shpenzimet për këto qendra shëndetësore në mënyrë që shpenzimet të jenë në përputhje me nevojat reale dhe jo me numrin e mjekëve, infermierëve apo më keq akoma të sanitarëve që janë punësuar aty?

Por, me sa duket në gjykimin e ministrit, jo. Vendimi i tij për të shkurtuar staf duket se është mëse i prerë. Për më tepër ai ka pohuar se në qendrat spitalore si ato të: Mallakastrës, Malësisë së Madhe, Skraparit, Përmetit, Tepelenës, Ersekës, Delvinës, etj., 16 % e personelit i përket shërbimit sanitar. Pa shpjeguar se ç'të keqe ka këtu, ai merr vendimin e prerë se duhet të reduktohet numri i sanitarëve dhe buxheti i parashikuar për këtë kategori punonjësish duhet të shkojë për barna dhe forma të tjera shërbimi. Sa e turpshme aq dhe e dhimbshme!! Sa është pagesa e një sanitari në spital në Gramsh, Librazhd apo Sarandë? Sa është numri i të papunëve në këto qytete që ndonjëherë duket sikur dhe fati i ka harruar? No comment!!

Referenca:

Shqiptarja.com. *Protesta e mjekëve të Urgjencës. Reagon MSH: Do të ristrukturohet*

<http://shqiptarja.com/sociale/2750/protesta-e-mjkeve-te-urgjences-reagon-msh-do-te-ristrukturohet-339825.html>

Shkurt, 2016

Shqiptarja.com. *Mjekët peticion Ramës kundër mbylljes së Urgjencës së Tiraëns*
<http://shqiptarja.com/news.php?IDNotiza=339802> Shkurt, 2016

Gazeta MAPO. *Videot: Goditet me vezë Ilir Beqaj, ja si reagon Rama*
<http://www.mapo.al/2016/02/tirane-goditet-me-veze-e-domate-ilir-beqaj>
Shkurt, 2016

Top Channel. *Mbyllja e urgjencës, mjekët: Të mos transferohet në periferi të Tiranës.*

<http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=318684>
Shkurt, 2016

Top Channel. *Beqaj: Urjenca, tani program më vete buxhetor.*
<http://www.top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=318697>
Shkurt, 2016

Shqiptarja.com. *Studim, spitalet e qyteteve të vogla "punojnë" si urgjenca.*
<http://shqiptarja.com/news.php?IDNotizia=340755> Shkurt, 2016

MINISTRIA E SHTETIT PËR ÇËSHTJET VENDORE

Mirilda TILI, BA

Në mes të të verbërve, kush ka një sy, ka edhe mundësinë për të parë qartë bëmat dhe zhvillimet e vendit. Lumturia që kaploi qeverisjen aktuale pas publikimit të rezultateve të Transparency International, se perceptimi i korrupsionit ka pasur përmirësim, APPA-s ngre pyetjen. A është perceptimi i korrupsionit në të njëjtin nivel me atë që ka në realitet? Dhe në serinë e pyetjeve do të vazhdojmë të kërkojmë të dimë se çfarë ka ndodhur. A është ulur niveli i korrupsionit në vend apo në të vërtetë mungesa e transparencës sjell edhe vetëbesimin se mund të jemi më mirë.

Megjithatë të gjithë gëzimin e madh që vendi ynë, tashmë renditet në vendin e 88 për sa i përket perceptimit të korrupsionit, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Bledi Çuçi, e konsideroi në deklaratrën e tij për shtyp si një arritje të qeverisë. *"Shqipëria ka fituar pikët më të larta në gjithë historinë që kur Transparency International ka filluar matjen e këtij perceptimi dhe është ngjitur 22 vende më lart për vetëm një vit - nga vendi 110 në vitin 2014, në vendin e 88-të, në 2015 - në përmirësimin e perceptimit publik për korrupsionin. Ky rezultat nuk do të thotë se i kemi mbërritur të gjitha objektivat në luftën kundër korrupsionit, por ai dëshmon qartësisht se jemi në drejtimin e duhur për të mposhtur fuqinë e trashëguar të korrupsionit dhe për të fituar, së bashku me çdo shqiptar e shqiptare, luftën për të çliruar shoqërinë tonë nga ky makth që pengon zhvillimin dhe minon demokracinë".*

Nisur po nga ky entuziazëm, pra lufta kundër korrupsionit, po e njëjta misnitri ka dalë para komisionit të ligjeve me projektligjin për "mbrojtjen e sinjalizuesëve". Kjo do të thotë mbrojtjen e atyre që sinjalizojnë për rastet korruptive. E thënë më thjesht, ata që do të sinjalizojnë në raste të abuzimit me fondet publike apo çdo lloj forme tjetër korrupsioni, do të mbrohen me ligj. Por në këtë projektligj, thuhet se sinjalizuesit nuk do të paguhën. Pra do të jenë spinë falas. Në këtë kuadër do të pyesim, a nuk janë mjaftueshëm të gjitha faqet zyrtare që kanë për qëllim denoncimin? Ecim edhe më tej. I gjithë ky zell për të frymëzuar denoncimin, a ka të njëjtin zell edhe për të hetuar dhe ndëshkuar në raste verifikimi të denoncuarin? Por duke qenë në kuadrin e fjalëve, në datën 29 janar është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi mes Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore dhe Prokurorisë së Përgjithshme për përdorimin e sistemit elektronik për regjistrimin dhe gjurmimin e të dhënave mbi rastet e korrupsionit dhe statistikave të harmonizuara. Nga ky memorandum bashkëpunimi janë sqaruar kompetencat e secilit dikaster, por nuk është bërë publike se cila do të jetë firma që do të merret me këtë çështje, ose si do të përzgjidhet grupi i punës.

<http://ëëë.ceshtjetvendore.gov.al/>

[http://ëëë.ceshtjetvendore.gov.al/files/serfiles/ProkuriaP.pdf](http://ëëë.ceshtjetvendore.gov.al/files/userfiles/ProkuriaP.pdf)

MINISTRIA E SHTETIT PËR INOACION DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Mirilda TILI, BA

1. Shumë zhurmë për asgjë.

“ U mbars mali dhe polli një mi”- kështu do të perifrazoja të gjithë punën e Ministrisë së Shtetit për Inovacion dhe Administratën Publike për dy muajt e parë të vitit. Kjo ministri përgjatë kësaj periudhe ka bërë publikime aktiviteteve në mënyrë periodike. E thënë në terma gazetareskë, kanë pasur gjithmonë mundësi të jenë prezentë në kronika lajmesh apo edhe publikime portalesh. Aktivitet i rëndësishëm mund të konsiderohej mbledhja e 4 ministrive dhe e disa dhjetra drejtorive në kuadër të ditës ndërkombëtare të “Internetit të sigurt” (Safer Internet Day). “Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, me mbështetjen e UNICEF kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synon rritjen e efikasitetit të ndërveprimit institucional në funksion të sigurisë online për fëmijët. Marrëveshja ka për qëllim rritjen dhe promovimin e sigurisë online të fëmijëve ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna, shfrytëzimi, abuzimi, rreziqet dhe kërcënimet që vijnë nga përdorimi i internetit në Shqipëri”. Deri në këtë pikë nuk ka asnjë gjë të keqe, madje, është një nismë shumë e mirë. Ajo për të cilën kemi vërejtjet tona është fakti që nga e gjithë kjo marrëveshje nuk është thënë asnjë gjë konkrete se si do të realizohet,

cilat janë detyrat e secilit dikaster, cilat do të jenë masat konkrete dhe penalizimet për abuzuesit. Dhe sikur të mos mbarojë me kaq, ajo për të cilën kemi shqetësim edhe më të madh, është numri shumë i kufizuar i atyre që do tju hyjë në punë ky projekt. Kjo sepse realiteti në vend na ka treguar qartë që jotë gjithë fëmijët janë të rrezikuar nga kibernetika. Kjo sepse jo të gjithë e kanë mundësinë të përdorin internetin. Madje shumë e shumë shkolla në vend nuk kanë as laboratorë normal me provëza kimie apo gjethe për lëndën e biologjisë. Në ato shkolla mungojnë kompiuterat për të zhvilluar mësimin normalisht. Por ... duke e lënë pas këtë realitet që ngjyrat e letërsisë do të shkruanin perla, në realitet ky projekt është i pazbardhur nga detajet. Eksperiencat treguar se sa më shumë dikastere të përfshihen aq më shumë zhurmë ka dhe aq më pak punë bëhet. Do të përmendim fushatën sensibilizuese të vitit 2011, për të hequr fëmijët nga rruga. U bë një projekt “gjigand”. Edhe qytetarët penalizoheshin ligjërisht në momentin që përballeshin më një fëmijë që lypte dhe nuk e denonconin. Media oshëtinte nga të katërta anët për zgjidhjen e këtij problemi. Sot, pas 5 vitesh, asnjë fëmijë nuk ka dalë nga rruga dhe është rehabilituar si pasojë e atij projekti.

2. Sugjerime:

Në rastin më të mirë që kjo ministri, së bashku me homologët e veta, nëse e ka marrë shumë seriozisht mbrojtjen e fëmijëve, atëherë le të investojë në sigurimin e programeve filtruese që prindërit t’i instalojnë në kompjuterat e tyre dhe ky është një përfitim më i drejtpërdrejtë. Ndërsa për ata të tjerë që

kompjuterit i'a kanë dëgjuar vetëm emrin nga televizori, t'ju siguhen laboratore ku të zhvillojnë mësim normalisht.

3. Çfarë lamë pa thënë?

Për periudhën 2 mujore, lamë pas edhe akktivitetet të tjera ku Ministrja Znj. Milena Harito ka marrë pjesë dhe ka mabjtur edhe fjalën e radhës. Por ajo që ne nuk do e anashkalojmë është raport – analiza e vitit 2015. Në të gjithë raportin është bërë një lojë fjalësh përsa i përket të punësuarve në administratën publike. Edhe kësaj here faji është i shqiptarëve të papunë që nuk janë të aftë të kryejnë detyra të caktuara. Nga 1006 vende pune, të shpallura vakant nga DAP, vetëm 650 arritën të plotësoheshin. Nëse jemi vetëm shumë pak vigjilentë do të kuptojmë se 100 mijë vendet e punës që do të hapeshin, jo vetëm që nuk janë në plan, por as ato 1 mijë të shpallurat është një shifër që nuk do të shohë realizim.

Duhet theksuar se Ministrja e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ka paur si dëgjues të gjitha institucionet e varësisë, Departamenti i Administratës Publike (DAP), Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Agjencia Kombëtare e Informacionit Gjeohapësinor (ASIG), Agjencia Kombëtare për Sigurisë Kompjuterike (ALCIRT) dhe Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE). Dhe përveç kësaj ka një zyrë shtypi shumë të mirë e cila është e gatshme të shkruajë çdo ditë, mjafton që

në web të ketë "informacion të ri" paqka se asnjë gjë nuk pasqyrohet në të.

Referenca:

<http://www.isigurt.al/>

<http://www.inovacioni.gov.al/>

MINISTER SHTETI PER MARREDHENIET ME PARLAMENTIN

Mirilda Tili, BA

Duhej të ishte një shënjestër e gabuar, pra, një vezë e drejtuar për nga kryeminsitri i vendit, Edi Rama, dhe më pas të përfundonte tek Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, që të mund t'i dëgjonim t'i përmendej emri zonjës Ermonela Felaj. Në këtë fillim viti të ri, edhe pse kaluan 60 ditë kalendarike, nuk e kemi parë as më zë e as më figurë këtë ministre dhe sigurisht as atë që ajo përfaqëson. Përkundër kësaj, edhe pse më zë të lartë apo jo, publikish apo nëpër tavolina kafenesh themi që kemi një qeveri që është në tratativa të të bërit marketing dhe përdoruese e "denjë" e teknologjisë, ministrisë për Marrëdhëniet me Parlamentin nuk i funksionon web site-i i tij.

Nëse çdo qytetar i këtij vendi, përqëndruar tek e drejta për informim, do të shprehë dëshirën legjitime të marrë vesh se ç'bëhet në këtë ministri, nuk do të gjejë asnjë lloj informacioni.

<http://www.marredhenietmeparlamentin.gov.al/>kyweb site, që normalisht duhet të publikonte çdo aktvitete të kësaj ministrie nuk funksionon.

A duhet të kuptojmë nga kjo që, meqënëse kjo ministri nuk ka çfarë bën dhe si rrjedhojë një web site, i cili pasqyron aktivitet nuk ka për çfarë të duhet?Mos ndoshta duhet të rritheksohet kërkesa dhe të merret parasysh ashtu sikundër duhet, që kjo ministri të mbyllet.

Në të gjithë hetimin dy mujor që kemi bërë në emër të zonjës Felaj, e vetmja "shenjë jete" përveç vendit të zënë në rreshtin e kabinetit qeverisës të ishte një vezë që pati një tjetër shënjestër dhe një tjetër vendodhje. Në media është përmendur vetëm një herë.

Minsitren Felaj e kap gabimisht një vezë e opozitës.

Me gjithë kërshërinë që patëm dhe dëshirën e mirë që të shihnim se çfarë ka bërë kjo ministri në këtë fillim viti, apo se cilat janë detyrat e shtëpisë për 2016-ën, ne "hetuam" edhe profilin personal në Facebook.

Wow një surprizë e madhe, fotoja e prrofilit lajmëron që në Partinë Socialiste, ka filluar fushata për anëtarësime. Ja për këtë, meqe nuk e dinim, na e lajmëroi ministria, se në fakt për këtë paguhet, meqë vetëështë pa portofol.

"Një ministër Shteti është një ministër që i atribuohet një titull honorifik, që mban parasysh personalitetin e tij ose vlerat e tij përfaqësuese. Një ministër i deleguar vendoset drejtpërsëdrejti nën autoritetin e Kryeministrit për të kryer një mision të veçantë. Një ministër pa portofol nuk është në krye të një ministrie, por ka titull ministri dhe bën pjesë në qeveri. Një ministër i plotfuqishëm është një person diplomatik, i rangut menjëherë mbas ambasadorëve"- e meqë qenka vetëm honorifik, këtë misnitri më mië ta myllin dhe t'ja shprehin mirënjohjen ministres në një tjetër formë.

Referenca:

<http://www.marredhenietmeparlamentin.gov.al/>

<https://www.facebook.com/ermonela.felaj>

<http://shtetiëeb.org/2012/09/07/funksionet-dhe-struktura-e-qeverise/>

<http://botasot.info/shqiperia/518662/kuvend-veze-ne-drejtim-te-kryeministrit-goditet-ermonela-felaj-video/>

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

Gerion TRESKA, MSc

1. Amanetet e para-ikjes së Ministrit Ahmetaj, Programi i Reformave "muskuloze" Ekonomike

"Muskuloze" madje edhe të dhimbshme por mbi të gjitha të dobishme i konsideroi Ministri Ahmetaj reformat ekonomike në vend gjatë Seminarit të Bankës Botërore me temë "Përshpejtimi i rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të barabartë në Shqipëri" në fund të muajit Janar.

Në brendësi të këtyre "muskujve" si në fjalimin e tij në Parlament por edhe në Programin e Reformave Ekonomike 2016-2018 shifrat dhe parashikimet duken mjaft pozitive dhe të ëmbla, aq optimiste madje sa edhe Standard and Poor's përmirësoi vlerësimin e borxhit të Shqipërisë nga B në B+ me perspektivë stabël, kjo mbase duke u bazuar në fjalimin e Ministrit Ahmetaj por edhe njëkohësisht ashtu siç S&P deklaroi, prezenca e FMN dhe marrëveshja me këtë institucion jep siguri dhe garanci për kryerjen e reformave të rëndësishme strukturore në disa fusha përfshirë atë të drejtësisë. Ajo çka bie në sy në këtë përputhje thuhetse perfekte janë parashikimet si të Ministrit Ahmetaj edhe të S&P për rritjen ekonomike me mesatarisht 4% nga 2016-2019. Patjetër që kjo është një reklamë e mirë ndaj investitorëve të huaj, madje më e mirë se sa ajo e fundit tek The Economist që Qeveria pagoi nga taksat që vjel nga qytetarët shqiptar.

Duke folur për investitorët e huaj vihet re se çmimi i naftës jo vetëm po largon investitorët e huaj nga Shqipëria, megjithëse Ministri Ahmetaj thotë se në krahasim me 2014 investimet e huaja shkuan nga 621 milion euro në 714 milion në 2015, madje parashikohen që të shkojnë në 950 milion, por gjithashtu po lëkund strukturën ekonomike të vendit.

Sipas Monitor, në listën e 10 sipërmarrjeve më të mëdha sipas xhiros për secilin vend të rajonit (përfshirë bankat e shoqëritë e sigurimit), Shqipëria "shquhet" për numrin e madh të kompanive në sektorin e naftës, me 6 të tilla, duke reflektuar qartazi strukturën e paqëndrueshme të ekonomisë vendase. Ndërsa vendet fqinje po tërheqin investitorë me emër dhe po zënë vendin e tyre në industrinë e Europës Juglindore, Shqipëria mbetet zbuluar përballë rënies së çmimeve të naftës.

Në kundërshtim me këtë Kryeministri në samitin e BERZH-it në Londër, deklaroi se Shqipëria ka hyrë tashmë në një proces zhvillimi ekonomik, falë modelit të ri që ka vënë në funksion qeveria e tij ku modeli i sotëm mbështetet kryesisht tek eksportet. Në anën tjetër të dhënat na tregojnë një zhvendosje krejtësisht të ekonomisë nga kompanitë e ndërtimit tek ato të tregtimit dhe prodhimit të naftës. A do të thotë kjo se Qeveria po "mburret" me eksportin e naftës? Apo kjo tablo tregon se sa të paqëndrueshëm jemi "në këmbët tona" në modelin dhe sistemin ekonomik?

Mbështetësi kryesor i Qeverisë Shqiptare, FMN, shprehet mjaft konservator në lidhje me atë çka po ndodh sidomos në luftën ndaj

informalitetit, një fushatë kjo e cila patjetër që afekton çdo xhep qytetari shqiptar, qoftë punëmarrës apo punëdhënës. Në raportin e saj mbi gjendjen e përgjithshme në Shqipëri, FMN shprehet se gjatë muajve të fundit, zyrtarë të Ministrisë së Financave pranuan nën zë se, ndonëse bizneset u trembën në periudhën e fushatës dhe regjistruan një numër të madh punonjësish, shumë u rikthyen te mosbindja duke i çregjistruar punonjësit më vonë. Dhe jo vetëm kaq por ndikimi i kësaj fushate ishte më shumë mikro se makro. Shprehimisht në raport theksohet se, *shumica e bizneseve të reja të regjistruara janë biznese mikro apo të vogla, të cilat kanë ndikim shumë të kufizuar në të ardhura. Praktikisht nuk ka pasur rritje në xhiron e deklaruar të bizneseve të regjistruara me TVSH. Reagimet në sjelle të biznesit, të tilla si deklarimi pak më i ulët se sa limiti i regjistrimit si biznes i madh apo ndarja e bizneseve të disa njësi, mund të tresin më tutje ndikimin e fushatës në të ardhurat fiskale.*

Për të përballuar me sukses këtë "valë" Qeveria Shqiptare punësoi 500 inspektorë të rinj taksash me supozimin se do të luftonte evazionin fiskal duke e rritur kështu koston e grumbullimit të taksave nga 1.5% në 2012 në 2% në 2015. Patjetër që numrat janë impresionues dhe 500 inspektorë është "një ushtri e tërë" por ndërsa propagandojmë dhe realizojmë numrin le të mos harrojmë për cilësinë e cila reflektohet më së miri në raportin e sipër përmendur të FMN.

Në të gjitha shifrat e mësipërme bëhet fjalë për para të cilat qarkullojnë brenda ekonomisë shqiptare por akoma më shumë para të cilat vilen dhe

grumbullohen nga çdo qytetar shqiptar i cili ka gjithashtu të drejtën të kërkojë informacion se ku shkojnë ato çka paguan pavarësisht se i kthehet përgjigje ose jo.

2. Si të falimentojmë me nder dhe lobim?!

Sipas Bankës së Shqipërisë 35 kompanitë ose bartësit që kanë borxhet më të këqija përbëjnë 52% të totalit të kredive me problem. Pra në Shqipëri nuk ka vetëm monopol ose oligopol të tregut të të mirave apo shërbimeve por tashmë edhe të kredive të këqija. Po sipas BSH, këto kompani ose grupe tregtare, të cilat nuk bëhen të ditura, kanë gati 500 milionë dollarë kredi të këqija, duke u shndërruar në burimin kryesor të pasigurive në sistemin financiar dhe ekonominë kombëtare. Me fjalë më të thjeshta akoma janë 35 kompani të cilat luajnë me sistemin si të duan, marrin kredi sa të duan dhe nuk falimentojnë.

Megjithëse BSH po bashkëpunon me FMN për gjetjen e zgjidhjes së kësaj situatë si dhe me bankat e nivelit të dytë për të patur një pasqyrë të qartë dhe reale mbi gjendjen kaq paralizuese që kanë krijuar këto kompani në nivel ekonomie kombëtare. Por masat do të merren vetëm pasi të miratohet ligji i ri i falimentimit. Fakti që këto kompani nuk bëhen transparente për publikun nuk lë një shije të mirë, pasi falimentimi ose rrudhja e këtyre kompanive patjetër që do të prekë ekonominë personale por edhe atë kombëtare. Ndërkohë që ligji i ri mbi falimentimin shkruhet, 35 kompanitë patjetër që mund të llobojnë dhe përgatiten për atë çka ky ligj i ri do të sjellë, madje eksperiencia ka treguar se pavarësisht sa borxhe kanë ato mund

edhe të shpëtojnë pa u hyrë ferrë në këmbë.

Referenca:

<http://acp.al/news/1851/BSH,-ne-mars-paraqitet-zgjidhja-per-kompanite-me-kredi-te-keqija/>

<http://acp.al/news/1852/Renditja:-Sipermarrjet-shqiptare,-xhungla-e-rajonit/>

<http://acp.al/news/1834/Rama-ne-samitin-e-BERZH:-Shqiperia,-drejt-nje-modeli-te-ri-ekonomik/>

<http://acp.al/news/1771/Standard-and-Poors:-Shqiperia-B+,-permiresohet-vleresimi-per-ekonomine/>

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/prezantohet-programi-i-reformave-ekonomike-2016-2018&page=1>

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/rritja-ekonomike-gjitheperfshirese-dhe-reduktimi-i-varferise-ne-shqiperi&page=2>

<http://www.reporter.al/shpenzimet-per-mbledhjen-e-taksave-rriten-te-ardhurat-jo-edhe-aq/>

<http://www.reporter.al/fmn-numri-i-bizneseve-te-regjistruara-u-rrit-por-te-ardhurat-jo/>

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

Mimi BARUSHI, MSc

1. Ku do t'i çojme sot familjet rome?

Fundi i 2015-s shënjoji përfundimin e hartimit të 3 planeve të shumëpërfolura kombëtare: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin dhe Plani Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës. Ndërkohë në 2016 do të ketë përparësi miratimi i planeve kombëtare, hartimi dhe miratimi i planeve vendore, strehimi i grupeve jo të favorizuara, legalizimi i objekteve në zona informale etj.

Sipas Ministres Gjermani gjatë vitit 2016 do të zbatohen projekte që lidhen me Komunitetin Rom dhe Egjiptian. Një buxhet prej 107 milionë lekësh do të përdoret për ndërtimin dhe rikonstruksionin e banesave të këtij komuniteti, nga ku përfitojnë 148 familje në 9 qytete të vendit. Në bashkëpunim mes strukturave paralele (ministritë) e vertikale (bashkitë dhe komunat), si edhe me mbështetje të donatorëve dhe pjesëmarrje të vetë komunitetit, do të hartohet plani i ndërhyrjes për përmirësimin e kushteve të banimit, të komunitetit Rom e Egjiptian. Ndërhyrjet do të synojnë rehabilitimin e vendbanimeve, shndërrimin e tyre, aty ku është e mundur, në "lagje të fqinjësisë së mirë" dhe modele të bashkëjetesës, mes komuniteteve të ndryshme.

Vetëm pak ditë pas prononcimit të znj.Gjermani, komuniteti rom në zona të ndryshme të Tiranës ka hasur problematika jetësore, ndaj të cilave është treguar vetëm apati institucionale

për një zgjidhje afatgjatë. Në fund janar, 92 anëtarë të komunitetit rom mbetën të pastrehë pasi barrakat e tyre, pranë urës së Babrrusë, u përmyten. Bashkia i strehoi në disa çadra e më pas në ish-repartin ushtarak në Tufinë. Kushtet e jetesës në repart, edhe pas ndërhyrjes në objekt janë të papërshtatshme për të jetuar aty për një kohë të gjatë.

Ndërkohë në zonën e Selitës, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, IKMT, shembi në mes të shkurtit shtëpitë e komunitetit rom nëpërmjet një procedure e cila binte në kundërshtim me ligjin, duke mos respektuar afatet paralajmëruese e pritëse, si dhe duke anashkaluar faktin që familjet e prekura kishin nisur prej muajsh procedurat për legalizimin e shtëpive të tyre. Bashkia e Tiranës në këtë rast, i ka ofruar familjeve vetëm dy vite qira, e jo dëmshpërblimin e duhur ose një shtrehim tjetër.

Në një letër nga Komisioneri European për të Drejtat e Njeriut, Shqipëria u kritikua për dëbimet e vazhdueshme (më I rëndësishmi: dëbimi I 48 familjeve nga territory I Liqenit Artificial në 2015) dhe mungesën e një strategjie afatgjatë të strehimit të komunitetit rom dhe egjiptian. Raportohet që Ministria Gjermani e ka lënë pa përgjigje letren e komisionerit të Këshillit të Europës, në shpresë që do t'i përgjigjet më një propozim e kohë veprimi konkrete.

2. Çfarë morëm menjëherë nga një vit më parë?

Në ditët e para të muajit janar, Ministria raportohet të ketë transferuar një shumë prej 517 mijë euro në llogari të "Kube

Studio", një kompani produksioni. Transferta e kryer përkatësisht me 18 dhe 31 dhjetor 2015 mbulon realizimin e 5 konferencave nëpër qytete të Shqipërisë dhe 27 spoteve me kohëzgjatje prej 20 sekondash në kuadër të komunikimit dhe sensibilizimit të publikut për planifikimin e territorit dhe për tre planet kombëtare. Dyshimi për njëshkelje të mundshme u ngrit pasi për tenderin nuk ishte degjuar thujse fare dhe kalimet e fondeve nuk rezultojnë të publikuara në buletinët zyrtarë elektronikë të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ato përshkruhen në thesar si kalim fondesh për "realizimin e spoteve publicitare për prezantimin e planit kombëtar të territorit". Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe vete Ministria Gjermane reagojnë publikisht për akuzat dhe sqarojnë se komunikimi është në mbështetje të nene-ve dhe VKM-ve. Fondi u përgenjstrua të jetë 517 mijë euro, por nuk u deklarua sa është realisht. Sado të jetë kostoja e tregut, kjo platformë është një luksi panevojshëm për publikun. Open Data Albania ka analizuar rastin, por artikulli nuk gjendet më në faqen e tyre online.

Gjithmonë e më shumë është vënë re shqetësimi midis komunitetit të arkitektëve për shpërndaerjen e pabalancuar të projekteve dhe financimeve publike, duke sjellë një situatë monopoli e ngërçi. Procedurat e shumta burokratike të kërkuara në konkurse nga Atelier Albania krijojnë shpenzime dhe vështirësi teknike që vetëm studiot e mëdha mund t'i përballojnë. Terminologjia e përdorur shpesh herë është e paqartë duke krijuar mundësi të shumta interpretimi si nga studiot pjesëmarrëse ashtu dhe nga juria

e konkursit. Kjo sjell drejtpërdrejtë penalizime që mund të ishin evituar që në fillim. Pjesëtarët e jurive janë gjithmonë të diskutueshëm lidhur kjo me përzgjedhjen dhe profesionalizmin e tyre. Shoqata e Arkitektëve Shqiptarë nuk ka mbajtur asnjë qëndrim zyrtar për punën e zhvilluar në muajt e fundit. Ndërkohë Unioni i Arkitektëve Shqiptarë në një deklaratë kërkon nga autoritetet të:

1. Shmanginçdo pozicion monopolizues në tregun e brishtë dhe të dobët të projektimit arkitektonik.
2. Nxisin mbijetesën dhe rritjen e studiove të vogla dhe të mesme vendase

3- Zhblllokohen lejet e ndërtimit

Të bllokuara që nga 03.10.2015, ditë kur Këshilli Kombëtar i Territorit miratoi nismën për hartimin e Planit Kombëtar të Territorit, lejet e ndërtimit po shohin dritën jeshile. Vendimi I KKT përcaktonte se deri në hartimin e planeve të reja vendore nuk mund të jepej asnjë leje e re ndërtimi. Në fakt ky vendim përjashtonte disa tipologji të vogla ndërtimi ose ndërhyrje urgjente, por nuk përjashtonte pallate apo objekte me sipërfaqe të mëdha shfrytëzimi. Të gjitha rastet e lartpërmendura duhet të shoqëroheshin me procedura të posaçme. KKT ka kërkuar që 61 bashkitë e reja të krijuara nga reforma territoriale të angazhohen për plane të reja vendore, proces ky i nisur nga disa vite tashme dhe përfundon në korrik.

Nëpërmjet një letre, ministrja e Zhvillimit Urban, Gjermane u ka dërguar 61 bashkive të vendit një përkujtesë për t'i rikujtuar procedurat e dhënies së lejeve ndërtimore, mundësitë dhe përgjegjësitë ligjore që ato kanë karshi qytetarëve. Planet rregulluese nuk duhet

të konsideroheshin faktorë pengues për bashkitë, e përseri janë marrë si justifikim për të vonuar proceset e dhënieve të lejeve të ndërtimit.

Referenca:

<http://shqiptarja.com/Politike/2732/n--26-bashki-bllokohen-lejet-e-nd-rtimit-do-ket--plane-t--reja-308313.html>

<http://www.panorama.com.al/dokumenti-rama-pezullon-lejet-e-ndertimit-per-nje-vit/>

<http://www.citynews.al/2016/02/studio-e-alban-eftimit-perfitoi-1-87-miliarde-leke-nga-qeveria/>

<http://www.oranews.tv/vendi/gjermani-leter-bashkive-per-lejet-e-ndertimit-mos-i-bllokoni-planet-perfundojne-ne-korrik/>

<http://www.oranews.tv/vendi/zhvillimi-i-qyteteve-gjermani-bashkive-dorezoni-projekte-te-merrni-fonde/>

<http://www.oranews.tv/vendi/ministrja-gjermani-shpenzime-per-spote-e-konferenca/>

<http://www.respublica.al/2016/01/08/i-del-z%C3%ABri-edhe-ministris%C3%AB-s%C3%AB-gjermenit-517-mij%C3%AB-euro-p%C3%AB-spote-reagon-akpt-ja>

<http://www.panorama.com.al/dokumenti-rama-pezullon-lejet-e-ndertimit-per-nje-vit/>

<http://www.panorama.com.al/lejet-e-ndertimit-gjermani-leter-bashkive-mos-bllokoni/>

<http://www.reporter.al/avokati-i-popullit-shembjet-e-shtepive-te-komunitetit-rom-tek-unaza-e-re-te-paligjshme/>

<http://www.reporter.al/keshilli-i-europes-kritikon-shqiperine-per-perzeniet-e-romeve/>